REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

# RAPORTI I MONITORIMIT 2017

# STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE KUNDËR KORRUPSIONIT 2015-2020

# TABELA E PËRMBAJTJES


LISTA E SHKURTIMEVE ........................................................................................ 3
I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE ................................................................................ 5
II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT ........................................................................ 8
III. PROGRESI I ZBATIMIT ..................................................................................... 9
IV. DISBURSIMI FINANCIAR ................................................................................... 12
V. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE ........................................................ 12
V.1 Progresi i objektivave të qasjes parandaluese ........................................................ 13
V.2 Progresi i objektivave të qasjes ndëshkimore ........................................................ 166
V.3 Progresi i objektivave të qasjes ndërgjegjësuese ..................................................... 19
VI. PARAQITJE E DETAJUAR E ZBATIMIT ............................................................... 21
VII. REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE .................................................................. 99
VIII. SFIDAT ........................................................................................................ 100

# LISTA E SHKURTIMEVE

AAPSK Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara

ADISA Albanian Delivery Integrated Servcies Agency (Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara)

AIDA Albanian Investments Development Agency (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve)

AKBN Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore

AKM Agjencia Kombëtare e Mjedisit

ATP Agjencia për Trajtimin e Pronave

AKPT Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit

AKSHI Agjencia Kombëtare për Shoqërine e Informacionit

AKU Autoriteti Kombëtar i Ushqimit

AMSHC Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile

AP Avokati i Popullit APP Agjencia e Prokurimit Publik

AQTN Arkivi Qëndror Teknik i Ndërtimit

ASIG Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapsinor

ASPA Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

AKT Agjencia e Trajtimit të Konçesioneve

BKH Byroja Kombëtare e Hetimit

BSH Banka e Shqipërisë

DAP Departamenti i Administratës Publike

DPB Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve

DPD Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

DPM Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë

MFE Ministria e, Financave dhe Ekonomise

DPPSH Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

DPPPP Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

DPSHP Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Provës

DPSHTRR Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor

DPS Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit

DPT Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

IQ Inspektoriati Qëndror

ILDKPKI Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave

IQT Inspektorati Qëndror Teknik

ISHPSHSH Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe i Shërbimeve Shoqërore

KDIMDP Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

KLD Këshilli i Lartë i Drejtësisë

KLSH Kontrolli i Lartë i Shtetit

KM Këshilli i Ministrave

KQZ Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

MAS Ministria e Arsimit dhe Sportit

MBZHR Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural

MD Ministria e Drejtësisë

MEI Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë

MK Ministria e Kulturës

MTM Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

MMB Ministria e Mbrojtjes

MSHMS Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqënies Sociale

MPB Ministria e Punëve të Brendshme

MEPJ Ministria e Europës dhe Punëve të Jashtme

PP Prokuroria e Përgjithshme

PV Plan Veprimi

QKR Qëndra Kombëtare e Regjistrimit

SHISH Shërbimi Informativ Shtetëror

SHM Shkolla e Magjistraturës

SHSSH Shërbimi Social Shtetëror

SNKK Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020

SNRAP Strategjia Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike 2015-2020

ZPKR Zyra e Prokurorisë për Krimet e Rënda

ZRPP Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

# I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky raport është hartuar në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit të Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2020 dhe përbën raportin e pestë të monitorimit. Raporti i monitorimi mbulon progresin gjatë vitit 2017 dhe monitorimi është realizuar nëpërmjet raportimit të Pikave të Kontaktit Antikorrupsion.

Plani i Veprimit përmban në total 191 masa, prej të cilave 143 masa me objektiv parandalimin, 26 masa me objektiv ndëshkimin e korrupsionit dhe 22 masa me karakter ndërgjegjësues. Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për vitin 2017 rezulton se niveli i zbatimit të masave të planit të veprimit është si më poshtë:

| Statusi i zbatimit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
|---|---|---|
| Të zbatuara plotësisht | 101 | 53% |
| Pjesërisht të zbatuara | 61 | 32% |
| Të pa-zbatuara | 14 | 7% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 15 | 8% |
| **TOTAL** | **191** | **100%** |

Në vijim paraqitja grafike e ecurisë së përgjithshme të zbatimit të masave të Planit të Veprimit për vitin 2017

Grafiku 1 Ecuria e përgjithshme zbatimit



Duke krahasuar zbatueshmërinë e vitit 2016 me vitin 2017 rezulton se:

**Numri i masave është i njëjtë 191**

- Gjatë vitit 2017, ka patur një rritje me rreth 14% të masave të zbatuara plotësisht (përkatësisht 26 masa më shumë) krahasuar me vitin 2016;

- Gjatë vitit 2017, ka një rënie prej rreth 15% të masave në pjesërisht të zbatuara, me 28 masa më pak se gjatë 2016;

- Gjatë vitit 2017 ka rritje me 7% lidhur me masat e pazbatuara, 12 masa më pak krahasuar me 2016;

- Gjatë vitit 2017 ka rritje në masën 8% më shumë se 2016, 15 masa nuk janë raportuar, krahasuar me 1 masë në 2016.

**Tabela 1 Statusi i krahasuar i zbatimit të masave të Planit të Veprimit 2016- 2017**

| Statusi i zbatimit | 2016 | | 2017 | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
| Të zbatuara plotësisht | 75 | 39% | 101 | 53% |
| Pjesërisht të zbatuara | 89 | 47% | 61 | 32% |
| Të pa-zbatuara | 26 | 14% | 14 | 7% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 1 | 0% | 15 | 8% |
| **TOTAL** | **191** | **100%** | **191** | **100%** |

**Grafiku 2. Statusi i masave të Planit të Veprimit 2017**



**Grafiku 3. Statusi i masave të Planit të Veprimit 2016**




**Grafiku 4. Ecuria e përgjithshme e zbatimit (krahasim viti 2016 me 2017)**



Bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të raportimit për vitin 2017 rezulton se niveli i zbatimit të masave të planit të veprimit është:

**Tabela 1 Tabela mbi numrin e masave**

| Masa | Të zbatuara | Pjesërisht të zbatuara | Të pazbatuara | Pa raportuar |
|---|---|---|---|---|
| **Qasja parandaluese** | 74 | 47 | 11 | 11 |
| **Qasja ndëshkimore** | 11 | 12 | 3 | 0 |
| **Qasja Ndërgjegjësuese** | 16 | 2 | - | 4 |
| **Totali** | 101 | 61 | 14 | 15 |

**Tabela 2 Tabela mbi gjendjen e zbatimit**

| Statusi i Zbatimit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
|---|---|---|
| **Të zbatuara** | **101** | **53%** |
| **Pjesërisht të zbatuara** | **61** | **32%** |
| **Të pa zbatuara** | **14** | **7%** |
| **Pa raportuar** | **15** | **8%** |
| **Totali** | **191** | **100 %** |

**Tabela 3 Statusi i krahasuar i zbatimit të masave të Planit të Veprimit 2016- 2017**

| Statusi i Zbatimit | Viti 2016 | | Viti 2017 | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
| **Të zbatuara** | **75** | **39%** | **101** | **53%** |
| **Pjesërisht të zbatuara** | **89** | **47%** | **61** | **32%** |
| **Të pa zbatuara** | **26** | **14%** | **14** | **7 %** |
| **Pa raportuar** | **1** | **0%** | **15** | **8%** |
| **Totali** | **191** | **100%** | **191** | **100 %** |

# II. METODOLOGJIA E MONITORIMIT

**Monitorimi i Strategjisë ka konsistuar në dy faza kryesore:**

1. Raportimi i institucioneve mes pikave të kontaktit, mbi zbatimin e masave për të cilat janë përgjegjëse; dhe
2. Raportimi nga KKK mbi zbatimin e PV-së në tërësinë e tij.

Raporti i Monitorimit ka kërkuar një proçes të përbërë nga 2 etapa raportimi për shumicën e institucioneve me qëllim plotësimin dhe saktësimin e informacionit të kërkuar. Zgjatja e proçesit të raportimit ka qenë e nevojshme, pasi raportimi në raundet e para rezultoi i paplotë ose i paqartë në shumë nga komponentët e Matricës së Raportimit.

Në vijim, janë trajtuar të dhënat për secilën etapë dhe janë përgatitur udhëzimet me informacionet shtesë që institucionet duhet të plotësonin për kuadrin e nevojshëm të të dhënave. Verifikimi i të dhënave të raportuara është kryer pjesërisht on-line nga KKK, për ato masa të cilat pikat e kontaktit kishin kryer raportimin, për të siguruar saktësinë e tyre. Trajtimi statistikor është kryer nëpërmjet kodifikimit të përgjigjeve bazuar në raportimet e mbledhur

# III. PROGRESI I ZBATIMIT

Tabela e mëposhtme pasqyron progresin në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet vlerave të treguesve të përgjithshëm të impaktit të Strategjisë:

**Tabela 4 PROGRESI I ZBATIMIT**

| **Përshkrimi i treguesit** | **Baseline/ Pikat kryesore** | **Synimi për 2018** | **Synimi për 2020** | **Arritja në periudhën e raportimit** |
|---|---|---|---|---|
| **Indeksi i perceptimit të Korrupsionit** *TransparencyInternational* | Sipas matjes të indeksit (0-100, ku 0 përkon me nivel të lartë korrupsioni, dhe 100 përkon me nivel të ulët korrupsioni) Shqipëria ka indeksin 38. | **37.5** (Rritje prej .5-2.5 pikësh çdo vit) | **40.5** (Rritje prej 1.5- 2.5 pikësh çdo vit) | **38** Shqipëria për vitin 2017 është renditur e 91_ta në listën e 168 vendeve të përzgjedhura për studim. Në 2016 ne renditeshim në vendin 83 gjë që tregon përkeqësim me 8 pikë. Persa i përket indeksit të perceptimit që ka shoqeria për korrupsionin kemi një rritje me 1 pikë karahasuar me 2016. |
| **Kontrolli i Korrupsionit, Banka Botërore** | Indikator i përbërë i cili mat gjëndjen e korrupsionit dhe evidenton përqindjen e vendeve që janë nën atë performancë Shqipëria | Shqipëria performon më mirë se 34% e vëndeve të tjera që vlerësohen lidhur me korrupsionin | Shqipëria performon më mirë se 40% e vendeve të tjera që vlerësohen lidhur me korrupsionin | **Nuk ka pasur raport të ri për këtë tregues.** Ky indikator në 2015 shënoi një përmirësim, duke kapur nivelin 40.4 %. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | renditet më mire se 25.84% e vendeve të tjera që vlerësohen. | | | |
| **Studimi mbi performancën e Mjedisit të Sipërmarrjes dhe të Investimeve, Banka Botërore** | Si në studimin e 2005, ashtu edhe të 2008, korrupsioni ishte pengesë e rëndësishme për biznesin (renditur i dyti në rendësi) | Korrupsioni nuk përbën një nga 3 pengesat më të rëndësishme për biznesin | Korrupsioni nuk përbën një nga 4 pengesat më të rëndësishme për biznesin | **Nuk ka pasur raport të ri për këtë tregues**. Në studimin e 2013-2014, rezulton se ka pasur disa përmirësime krahasuar me rezultatet e studimeve të mëparshme, gjithsesi korrupsioni përbën një nga 3 pengesat më të rëndësishme për biznesin |
| **Raport "Nations in Transit", Freedomhouse** | Vlerësimi për situatën e korrupsionit në Shqipëri është 5.25 (ku 1=shumë mirë, 7= shumë keq) Mesatarja e vlerësimeve për vendet e BE është 3.43 ndërsa për vendet e Ballkanit 4.79 | Vlerësimi për Shqipërinë është 4.5 | Vlerësimi për Shqipërinë është 4.2 | **Vlerësimi për 2017** mbetet i pandryshuar në krahasim me 2016. Vlerësimi për Shqipërinë është 5.25. |
| **Rekomandimet e GRECO për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktin e interesit në rradhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe parlamentarëve** | 10 rekomandime janë dhënë për Shqipërinë në raundin e 4-t të vlerësimeve, në 2014 nga te cilat Shqipëria ka plotësuar 1 rekomandim në mënyrë të kënaqshme dhe 9 të tjera në mënyrë të pjesëshme. | Të gjitha rekomandimet e raundit të 4-t janë zbatuar plotësisht | Të gjitha rekomandimet e raundit të 5-t janë zbatuar plotësisht | Raporti i GRECO mbi raundin e 4 të vlerësimit është publikuar në dt. 15.04.2016. 9 nga 10 rekomandime të GRECO janë vlerësuar "pjesërisht të zbatuara", ndërsa rekomandimi i 10-të u konsiderua "i zbatuar në mënyrë të kënaqshme".<br><br>Aktualisht është në proçes vlerësimi të dytë në kuadër të të njëjtit raund Nr. 4. |

**Të dhënat krahasuese për korrupsionin në rajon**






# IV. DISBURSIMI FINANCIAR

Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e Planit të Veprimit 2015-2017 është 1,7 Mld Lek, ose 12,3 Mln Euro. Sipas Strategjisë, financimi i Planit të Veprimit realizohet nga dy burime kryesore: buxheti i shtetit dhe mbështetja financiare e partnerëve ndërkombëtarë të zhvillimit. Buxheti i Shtetit është parashikuar të financojë zbatimin e aktiviteteve të planit të veprimit masën 49% të financimit të nevojshëm. Ndërsa pjesa tjetër është parashikuar të financohet nga partnerët ndërkombëtarë të zhvillimit si Bashkimi Europian, Banka Botërore, UNDP, OSBE, USAID, etj.

Në momentin e hartimit të planit të veprimit hendeku financiar është vlerësuar të jetë në masën 23% të totalit. Meqënëse hendeku financiar apo edhe kosto e përgjithshme e PV 2015-2017 nuk është rishikuar që prej aprovimit të Strategjisë, statistikat financiare të raportuara në vijim i referohen shifrave në momentin e miratimit të planit të veprimit.

Në kuadër të monitorimit të zbatimit të aktiviteteve të planit të veprimit, institucioneve përgjegjëse u është kërkuar të raportojnë mbi masën e disbursimit financiar në bazë aktiviteti të kryer. Nga analiza për aktivitetet e raportuara rezulton se:

- ***Financimi për vitin 2017 nga buxheti i shtetit është në shumën 233,532,144 lekë;***
- ***Financimi për 2017 nga donatorët është në shumën 122,093,312 lekë.***

# V. PROGRESI I ZBATIMIT SIPAS OBJEKTIVAVE

Ky kapitull do të përshkruajë progresin e arritur në kuadër të përmbushjes së objektivave të secilës qasje të Strategjisë dhe do të pasqyrojë grafikisht statusin e zbatimit të Strategjisë për vitin 2017.

***Ecuria e progresit në periudhën e monitoruar është klasifikuar në 3 kategori:***

- **I zbatuar:** Institucionet kanë raportuar “I zbatuar” zbatimin e Masës për periudhën e raportit me të gjithë treguesit e zbatimit. Për masat me tregues zbatimi periodik, institucionet kanë paraqitur edhe hapat në vijim.
- **Pjesërisht i zbatuar:** Institucionet kanë raportuar me këtë status ato Masa për të cilat në periudhën e raportit ka pasur zbatim të pjesshëm. Institucionet kanë raportuar edhe mbi hapat ne vijim për zbatimin e plotë të Masës.
- **I pa-zbatuar:** Të pa-zbatuara janë raportuar ato masa të cilat nuk kanë regjistruar aktivitete për periudhën në fjalë. Gjatë proçesit të raportimit, është synuar mbledhja e informacionit edhe në lidhje me hapat që institucionet e përfshira planifikojnë të ndërmarrin në periudhën pasuese.

Në një kategori tjetër përfshihen masat për të cilat institucionet përgjegjëse nuk kanë raportuar.

## V.1 Progresi i objektivave të qasjes parandaluese

***Qasja parandaluese*** shënon numrin më të madh të aktiviteteve që institucionet përgjegjëse planifikohet të zbatojnë gjatë gjithë periudhës 3-vjeçare të Planit të Veprimit. Gjatë periudhës së raportimit (viti 2017), institucionet përgjegjëse kanë raportuar: 74 masa të zbatuara, 47 ende të pa-zbatuara dhe 11 pjesërisht të zbatuara. Institucionet nuk kanë raportuar progres të zbatimit vetëm për 11 masa.

**Tabela 5 Progresi i krahasuar i zbatimit- Qasja Parandaluese**

| QASJA PARANDALUESE | 2016 | | 2017 | |
|---|---|---|---|---|
| Statusi i zbatimit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
| Të zbatuara plotësisht | 56 | 39% | 74 | 52% |
| Pjesërisht të zbatuara | 64 | 45% | 47 | 33% |
| Të pa-zbatuara | 22 | 15% | 11 | 7,5% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 1 | 1% | 11 | 7,5% |
| TOTAL | **143** | **100%** | **143** | **100%** |






**Arritjet kryesore në objektivat e qasjes parandaluese**

- Punësimet në 38 DAR/ZA realizohet nëpërmjet Portalit dhe mësues të kualifikuar dhe testuar janë pjesë e mësimdhënies.
- Është realizuar hartimi dhe publikimi i manualeve standarde për procedurat e koncesioneve si dhe janë realizuar rreth 8 workshope për këtë qëllim në 8 bashki.
- Janë pajisur me 584 kamera vëzhgimi gjatë kryerjes së detyrave, punonjësit e policisë rrugore dhe patrullës së përgjithshme.
- Ka vazhduar publikimi i raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit të investimeve publike.
- Referuar zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit rezulton se deri në Dhjetor 2017, 181 institucione publike kanë miratuar dhe publikuar një program të transparencës.
- Ka vazhduar publikimi i dëgjesave dhe vendimeve në përfundim të procedurave paraprake për vlerësimin e ndikimit në mjedis si dhe publikimi i raporteve të monitorimit për ndikimin në mjedis të projekteve dhe numrit të ankesave nga publiku;
- Ka vazhduar transparenca për alokimin e 5 fondeve të menaxhuara nga AIDA që janë: i) Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë, 28.000.000 Lekë, ii) Fondi i Inovacionit 10.000.000 Lekë; iii) Fondi i Ekonomisë Kreative (Artizanatit) 10.000.000 Lekë ; iv) Fondi Start – up 10.000.000 Lekë, dhe v) Fondi për SME-të në zonat turistike/historike 10.000.000 Lekë.
- Nga ana e Ministrisë së Kulturës të gjithë hapat e procesit të projekteve në art kulturë dhe trashëgimi kulturore bëhen publike në faqen zyrtare të MK;

- ❖ Përsa i përket qëndrës së informimit të publikut në QSUT realizohen mbi 9000 prenontime konsultash në linjën 08002828 si dhe prezenciale/mbi 3500 përfitues shërbimesh të ndryshme.
- ❖ Është realizuar pilotimi e modelit të ri social, për sistemin e ri të vlerësimit të aftësisë së kufizuar (PAK) në vlerën 2,5 milion euro.
- ❖ Ka vazhduar gjatë vitit 2017 zbatimi i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik;
- ❖ Është publikuar lista e zezë e kompanive që kryejnë projektim, konsultim, zbatim projektesh në fushën e transportit në faqen e Agjensisë së Prokurimeve Publike.
- ❖ Ka vazhduar gjatë vitit 2017 publikimi i buxhetit dhe procedurave të prokurimit publik në faqen e Avokatit të Popullit.
- ❖ Gjatë vitit 2017 janë krijuar 4 qendra të ofrimeve të shërbimeve si sportel unik dhe në total, në sportelet e administruara nga ADISA ofrohen 344 shërbime publike, të institucioneve qendrore, vendore dhe të pavaruara;
- ❖ Në bashkëpunim me AKSHI-n është krijuar harta unike e vendimmarrjes dhe Agjencia e Trajtimit të Pronave ka ndëmarrë të gjitha masat për zbatimin e detyrave të planifikuara dhe Web GIS- është bërë funksional për vlerësimin e vendimeve, mbështetës për orientimin e punës branda sektorëve si dhe për pergatitjen e përgjigjeve ndaj qytetarëve.
- ❖ Gjeoportali Kombëtar është ndërtuar nga ASIG në kuadrin e krijimit të Infrastrukturës Kombëtare të Informacionit Gjeohapësinor;
- ❖ Referuar zbatimit të Ligjit të Bilbilfryrësve në total janë 163 njësi përgjegjëse të ngritura në sektorin publik dhe janë 436 njësi përgjegjëse të ngritura në sektorin privat;
- ❖ Duke filluar nga viti 2015 – dhjetor 2017, në portalin antikorrupsion janë regjistruar 19,295 ankesa, nga të cilat 1,396 janë paraqitur si raste të korrupsionit. 119 raste janë përcjellë në prokurori, janë marrë 658 masa administrative dhe 71 masa disiplinore duke përfshirë shumë shkarkime. Ky portal tashmë është transferuar për administrim pranë Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit;
- ❖ APP në bashkëpunim me ASPA kanë zhvilluar në total 5 sesione trajnimi 10-ditore ku janë trajnuar gjithsej 128 punonjës prokurimi;
- ❖ Janë publikuar rreth 13,799 deklarata të interesave private me kërkesë veçanërisht për zyrtarët e lartë dhe për ata të zgjedhur.
- ❖ Kuvendi miratoi ligjin nr.90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar dhe në përfundim të verifikimit KQZ vendosi sanksion adminitrativ me gjobë për 7 parti politike; Raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore dhe raportet e auditimit financiar më datë 12 dhjetor 2017 u publikuan në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së.
- ❖ Janë kryer 2 Teste Integriteti nga ku rezultoi se proçedurat doganore janë kryer në zbatim të Kodit Doganor dhe Dispozitave Zbatuese. Nuk ka pasur nevojë për trajnime/masa ndaj punonjësve objekt i testeve;

- Janë zhvilluar rreth 11 trajnime mbi Antikorrupsionin dhe Mirëqeverisjen ku janë trajnuan në total 333 nëpunës të Administratës Publike referuar sistemit të testimit të integritetit.

- Rerferuar zbatimit të projektit "Mbështetje për Antikorrupsionin në Shqipëri për vitin 2017 është mundësuar organizimi i 35 trajnimeve mbi Antikorrupsionin dhe Mirëqeverisjen ku u trajnuan 994 nëpunës të Administratës Publike, si dhe 5 përfaqësues të shoqatave të biznesit;

- Referuar “Sistemit për Menaxhimin Policor të Çështjes ka përfunduar trajnimi i 660 punonjësve të policisë (i të gjitha niveleve dhe funksioneve) të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Korçë;

- Janë ngritur zyrat me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike në 12 bashki me mbështetjen e DLDPsë (financuar nga SDC - Qeveria Zvicerane) në 5 bashki dhe atë të PLGP (USAID) në 6 bashki, si dhe është tenderuar dhe ka filluar zbatimi i kontratës “Krijimi i sporteleve me një ndalesë për shërbimet administrative në nivel vendor” në 49 bashki me mbështetjen e projektit STAR2.

## V.2 Progresi i objektivave të qasjes ndëshkimore

Në kuadër të ***qasjes ndëshkimore***, gjatë periudhës së raportimit, institucionet përgjegjëse kanë raportuar 11 Masa të zbatuara, 3 ende të pa-zbatuara dhe 12 pjesërisht të zbatuara. Në vijim, tabela përmbledhëse me statusin përkatës të zbatimit:

**Tabela 6 Statusi i krahasuar i zbatimit: Qasja Ndëshkimore**

| QASJA NDËRSHKIMORE | 2016 | | 2017 | |
|---|---|---|---|---|
| Statusi i zbatimit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
| Të zbatuara plotësisht | 6 | 23% | 11 | 42% |
| Pjesërisht të zbatuara | 17 | 65% | 12 | 46% |
| Të pa-zbatuara | 3 | 12% | 3 | 12% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 0 | 0% | 0 | 0% |
| **TOTALI** | **26** | **100%** | **26** | **100%** |

Grafiku 2 - Qasja ndëshkimore: Ecuria e zbatimit të masave, viti 2017




Grafiku në vijim ilustron ecurinë e zbatimit duke krahasuar dy raportet e monitorimit, vitin 2016 me vitin 2017. Vërehet një rritje e numrit të masave të zbatuara, një trend rënës për masat pjesërisht të zbatuara nga institucionet përgjegjëse.



**Arritjet kryesore në objektivat e qasjes ndëshkimore**

- Janë realizuar trajnime të përbashkëta me prokurorinë, të organizuar nga Akademia e Sigurisë Tiranë, por edhe institucione të tjera ligjzbatuese apo edhe të organizuara nga partnerët apo organizatat ndërkombëtare.

- Janë referuar 456 vepra penale për korrupsion dhe krime në detyrë, ku në 145 raste po kryhen hetime proaktive për korrupsion dhe krime në detyrë dhe janë realizuar 21 operacione policore.

- Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave ka kryer 56 inspektime në vend dhe 103 në distancë.

- Janë trajnuar 46 prokurorë dhe 25 gjyqtarë mbi çështje që lidhen me ndëshkimin e korrupsionit si dhe legjislacionin respektiv penal;

- DPPPP ka bërë 357 referime në organet kompetente (DPPSH dhe PP).

- Në korrik 2017 është nënshkruar marrëveshjen e bashkëpunimit për "Shkëmbimin e Informacionit Ndërmjet Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes së Policisë së Shtetit dhe Sistemit të Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë", ndërsa në Gusht 2017 është rënë dakort në parim me Zyrën Qendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit "Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme";

- Është miratuar ligji nr. 69/2017 datë 27.4.2017 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003, "Për përgjimin e komunikimeve elektronike", të ndryshuar.

- Me ligjin nr. 35/2017 janë miratuar rregullat e reja në Kodin e Proçedurave Penale, për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake deri në 6 muaj si dhe ndryshimet lidhur me imunitetin.

- Në muajin tetor 2017 është nënshkruar në Tiranë një Protokoll i cili përcakton modelin e marrëveshjes për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimi mes Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Çështjeve Kriminale dhe të Faljeve, pranë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Francës, ndërkohë që në muajin nëntor 2017 është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Apelit të Republikës së Turqisë dhe Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë.

## V.3 Progresi i objektivave të qasjes ndërgjegjësuese

Në kuadër të ***qasjes ndërgjegjësuese***, gjatë periudhës së raportit, institucionet përgjegjëse kanë raportuar 13 Masa të zbatuara, 1 ende të pa-zbatuara dhe 8 pjesërisht të zbatuara.

**Tabela 7 Statusi i krahasuar i zbatimit: Qasja Ndërgjegjësuese**

| QASJA NDËRGJEGJËSUESE Statusi i zbatimit | 2016 | | 2017 | |
|---|---|---|---|---|
| | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit | Numri i masave | Përqindja ndaj totalit |
| Të zbatuara plotësisht | 13 | 59% | 16 | 73% |
| Pjesërisht të zbatuara | 8 | 36% | 2 | 9% |
| Të pa-zbatuara | 1 | 5% | 0 | 0% |
| Të pa-raportuara nga institucionet përgjegjëse | 0 | 0% | 4 | 18% |
| **TOTALI** | **22** | **100%** | **22** | **100%** |

**Grafiku 2 Qasja Ndërgjegjësuese: Ecuria e zbatimit të masave, viti 2017**






*Nga grafiku rezulton rritje të qasjeve të zbatuara plotësisht me 3 masa, pjesërisht të zbatuara ulje në 6 masa në 2017.*

**Arritjet kryesore në objektivat e qasjes ndërgjegjësuese**

- ❖ Agjencia për Mbështejen e shoqërisë Civile ka akorduar një fond total prej 15,400,000 lekësh për financimin e projekteve me tematike dhe për qëllim luftën ndaj korrupsionit, çështje të monitorimit dhe të transparences. Këto projekte janë në ndjekje ose/dhe kanë përfunduar sipas termave të kontratës të lidhur mes OJF dhe AMSHC-së;
- ❖ Për zgjedhjet parlamentare 2017 u realizua fushata edukuese dhe informuese për zgjedhësit, në zbatim të strategjsë së edukimit zgjedhor të miratuar nga KQZ përmes 6 spoteve televizive të transmetuara 816 herë në 11 TV me shtrirje sinjali në të gjithë territorin dhe gjithashtu 24 h në faqen e 3 websiteve më të klikuara, 2 spoteve radiofonike të transmetuara 592 herë në 3 radio me shtrirje sinjali në të gjithë vendin, 8 modele posterash që u publikuan 126 herë në 9 gazeta me format të printuar, u dha informacion i plotë për veprat penale në zgjedhje dhe masën e dënimit për to, sipas ndryshimeve të Kodit Penal të majit 2017.
- ❖ Janë realizuar fushata ndërgjegjësuese për shmangien e korrupsionit në Sistemin e Burgjeve në 10 IEVP, të cilat u përzgjodhën për të qenë pjesë e kësaj fushate, nisur nga kapaciteti i institucioneve: IEVP Peqin, Lushnjë, Vaqarr, Durrës, Korçë, Rrogozhinë, Jordan Misja, Mine Peza, Ali Demi dhe Lezhë.

# VI. PARAQITJE E DETAJUAR E ZBATIMIT

Ky kapitull detajon masë për masë raportimin e çdo institucioni përgjegjës për periudhën e këtij raporti, sikurse dhe nënvizon rekomandimet për rishikim për çdo aktivitet. Kapitulli ofron gjithashtu informacion lidhur me statusin kumulativ, i cili merr parasysh raportimet e mëparshme dhe përcakton statusin përfundimtar të zbatimit të Masave të Planit të Veprimit.

| **Nr.** | ***Aktiviteti*** | ***Institucioni përgjegjës*** | ***Afati kohor*** | ***Statusi*** | ***Progresi*** | ***Problematikat & hapat e ardhshme*** | ***Buxheti i përdorur*** |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 1.1** | Finalizimi i regjistrit themeltar të vendimmarrjes së kthimit dhe kompensimit | AKKP | Maj 2015 | I zbatuar | Masë e zbatuar që në vitin 2015 | | |
| **A. 1.2** | Rekrutimi i punonjësve mësimore sipas profilit përkatës dhe në bazë të meritës e preferencës | MAS | 2015 - 2017 | I zbatuar | MASR ka zyrtarizuar nëpërmjet Udhëzimit 38, datë 06.10.2015 për "Proçedurat për lëvizjen paralele, emërimit dhe largimit nga puna të mësuesit në institucionin publik të arsimit parauniversitar", punësimin vetëm nëpërmjet portalit Mësues për Shqipërinë. Portali rankon sipas meritës dhe përgatitjes mësuesit pjesmarrës në konkurs cdo vit, sipas profilit të tyre. DAR/ZA shpallin vendet e lira të cilat plotësohen me personel sipas renditjes në portal. Punësimet në 38 DAR/ZA realizohet nëpërmjet Portalit; mësues të kualifikuar dhe testuar janë pjesë e mësimdhënies. | MASR gjatë vitit 2018 do të realizoj online përzgjedhjen e vendeve vakante për Mësuesit nëpërmjet Portalit me qëllim maksimizimin e transparencës dhe zbatimit të strategjisë së antikorrupsionit. | |
| **A. 1.3** | Vlerësimi vjetor i mësuesve në bazë perfomance. | MAS | 2015 - 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Mësuesit vlerësohen cdo vit, me anë të një formulari të standartizuar nga drejtuesi i shkollës, bazuar në dispozitat normative dhe akteve ligjore e nënligjore. Drejtorët e shkollave vlerësohen cdo vit, po ashtu me një formular standart, nga zyrat arsimore, ose drejtoritë arsimore. Tregues të | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | unifikuar vlerësimi për mësuesit dhe drejtuesit; Barazi dhe standart në vlerësimin e mësuesve dhe drejtuesve | | |
| **A. 1.4** | Vlerësim teknik i sistemit të integritetit akademik në arsimin e lartë, dhe vlerësimi i aplikimit të një sistemi elektronik për kontrollin e plagjiaturës | MAS | 2016-2017 | Pjesërisht i zbatuar | Po ngrihet grupi i punës i cili në bashkëpunim me IAL po shikon mundësitë për ngritjen e strukturës dhe sistemit të plagjaturës. Është diskutuar në disa takime me IAL, madje është provuar marrja e eksperiencës në vendet e rajonit. Vazhdon proçesi | vijon | për tu vlerësuar |
| **A. 1.5** | Publikimi në faqen e DPM-së të emrave të subjekteve të autorizuar për kryerjen e shërbimeve metrologjike | Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë (DPM) | Dhjetor 2015/2016/2017 | I zbatuar | Janë publikuar në faqen web të institucionit emrat e subjekteve të pajisur me autorizim, subjektet të cilëve u është revokuar autorizimi, si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të Ligjit, të zbatueshme në fushën e autorizimeve | nuk ka | 96 000 lekë |
| **A. 1.6** | Hartimi dhe publikimi i manualeve standarde për procedurat e koncesioneve | Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATK) | Korrik 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Për vitin 2017/ Mars-Prill 2017, janë realizuar organizimi i disa workshop-eve me grupe me të vogla në njësitë kryesore të qeverisjes vendore të cilët kanë parashtruar nevojën për të marrë më shumë informacion mbi procedurat për dhënien me koncesion. Këto workshope janë organizohen në Bashkinë Elbasan, Korçë, Berat, Durrës, Gjirokastër, Kukës dhe Shkodër. Afat i ri kohor I kryerjes së këtyre ëorkshopeve është periudha pra fundi i Tremujorit të I dhe fillimi i Tremujorit të II. | | |
| **A. 1.7** | Pajisja e punonjësve të policisë rrugore dhe patrullës së përgjithshme me kamera | PSH | Dhjetor 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Në strukturat e DVP Tiranë janë shpërndarë gjithsej 584 kamera, të ndara këto si;Kom Pol Nr 1, 70 kamera, Kom Poli nr 2, 55 kamera, Kom Pol nr 3, 58 kamera, Kom Pol nr | Përmirësimi I Proçedurave Standarte për trajtimin dhe administrimin e produktit të përfituar nga | Buxheti i Shtetit |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | vëzhgimi gjatë kryerjes së detyrave | | | | 4, 50 kamera, Kom Pol nr 5, 42 kamera, Kom Pol nr 6, 42 kamera, Kom Pol Vorë, 10 kamera, Seksioni i Forcës së Posaçme Shqiponja 67 kamera dhe Komisariati i Policisë Rrugore 190 kamera. Aktualisht nga verifikimi i gjendjes reale të kamerave të trupit rezulton se 72 kamera nuk janë në gjendje pune, janë jashtë funksionit, nga këto 21 kamera kanë pësuar defekte si pasojë e prodhimit nga fabrika të cilat mbulohen nga garancia dhe janë marrë përsipër për tu riparuar apo zëvendësuar nga kompania kontraktore, ndërsa 51 kamera janë përcaktuar nga specialistët e IT dhe kompanisë, me dëmtime fizike të shkaktuara nga pakujdesia e punonjësve të policisë. punonjësit e policisë të pajisur me kamera të trupit kryejnë dhe administrojnë nëpërmjet shkarkimit në serverin qendror, mesatarisht 800 deri në 1000 pamje filmike, në 24 orë, ose 24.000 pamje filmime në një muaj. Nga drejtuesit e DVP Tiranë dhe komisariateve në varësi që nga fillimi i implementimit të sistemit të kamerave janë dhënë gjithsej 23 masa disiplinore ndaj punonjësve të policisë për shkelje të procedurave standarde të kamerave të trupit. Ka pasur disa ankesa nga qytetarët për shërbimet e patrullës së përgjithshme dhe patrullës së policisë rrugore për veprime abuzive dhe ndëshkime jo të drejta apo sjellje jo korrekte dhe etike ndaj qytetarëve, kryesisht për vendosje të masave administrative gjoba, ku nga verifikimi i pamjeve filmike të kryera nga punonjësit e policisë ka rezultuar se pretendimet e qytetarëve nuk kanë qëndruar. | kamerat e trupit të policisë, në serverin qëndror. | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 1.8** | Hartimi i raporteve periodike dhe vjetore të monitorimit të investimeve publike | Ish MZHETTS<br><br>tani MFE | Çdo tre muaj 2015-2017 | I zbatuar | Vazhdon publikimi. | | Pa kosto |
| **A. 1.9** | Hartimi i Programeve të Transparencës sipas ligjit të ri për të drejtën e informimit | Të gjitha ministritë | 1 Maj 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Referuar zbatimit të ligjit për të drejtën e informimit rezulton se deri ne Dhjetor 2017, 181 institucione publike kanë miratuar dhe publikuar një program të transparencës. | Vazhdon | Pa kosto |
| **A. 1.10** | Krijimi i strukturave të nevojshme për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit | KDIMDP | 2015-2016 | I zbatuar | Drejtoria për të drejtën e informimit pranë Zyrës së Komisionerit është plotësuar si strukturë. Por duke marrë në konsideratë numrin e lartë të ankesave që depozitohen është e nevojshme shtimi i kësaj strukture. Gjithashtu thuajse të gjithë institucionet kanë caktuar personat përgjegjës/koordinatorët e të drejtës për informim pranë institucioneve të tyre. Tashmë është e nevojshme forcimi i kapaciteteve duke ofruar trajnime të ndryshme. Pas ristruktrumit të institucioneve të administratës qëndrore, tashmë të gjitha ministritë kanë caktuar koordinatorin e të drejtës për informim. | Do të vijojnë trajnimet pranë Shkollës së Administratës Publike por edhe trajnime nga ana e ekspertëve antikorrupsion | 2,033,704 lekë |
| **A. 1.11** | Instalimi i sistemit audio në të gjitha gjykatat e Republikës së Shqipërisë | MD | Dhjetor 2015 | I zbatuar | Sistemi audio funksionon ne 37 gjykata te shkalles se pare dhe te apelit. | | |
| **A. 1.12** | Publikimi i dëgjesave dhe vendimeve në përfundim të procedurave paraprake për vlerësimin e ndikimit në mjedis | Ministria e Mjedisit (MM) | Çdo tre muaj 2015-2017 | I zbatuar | Realizimi i dëgjesave me publikun është arritur në masën 99% (përvëc 6 dëgjësave të cilat kanë dështuar/nuk janë zhvilluar/ose është tërhequr zhvilluesi) 1. Nr I dëgjesave 322 2. Nr. pjesmarrsve 4830 3. Vendimet tek info@akm.gov.al 4. Raporte vjetore - Nuk | Në bazë të Legjislacionit në fuqi në AKM | Nuk ka |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ka<br>1. VKM NR.419 Datë 25.06.2014<br>2. VKM NR. 247 Datë 30.04.2014 "Për miratimin e rregullave, të kërkesave e të proçedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimarrjen mjedisore". | | |
| **A. 1.13** | Bërja publike e raporteve të monitorimit për ndikimin në mjedis të projekteve dhe e numrit të ankesave nga publiku | Ministria e Mjedisit (MM) | Çdo janar 2015-2017 | I zbatuar | Në WEB-in ëëë.akm.gov.al/publiku në vendimarrje janë publikuar të gjitha përmbledhjet joteknike për aplikimet për VNM të Thelluar dhe për aplikimet për Leje tipi A, B Në WEB-in e DRM -ve jane publikuar te gjitha Raportet e VNM për të gjitha aplikimet për VNM Paraprake.<br>2. Për këtë periudhë kohore në MTM janë shqyrtuar dhe trajtuar 15 ankesa në lidhje me raportet e monitorimit të ndikimit në mjedis nga ana e sektorit te VNM-së dhe VSM-se në Ministri. Janë marrë në shqyrtim të gjitha ankesat, dhe për secilën, rast pas rasti, është bërë shqyrtimi dhe kthimi në kohë i përgjigjeve, duke bërë të mundur zgjidhjen e problemit të ankesës sipas kapacitetit ligjor që mbart institucioni. Disa ankesa që kanë rezultuar jashtë kompetencës institucionale, janë deleguar për shqyrtim tek institucionet e tjera. 1.ëëë.akm.gov.al/publiku<br>2. Nr.ankesave të trajtuara nga AKM- 3<br>3. Nr I raporteve të trajtuara nga AKM - 100% 4. Numri i ankesave të trajtuara nga MTM në lidhje me raportet e monitorimit të ndikimit në mjedis është 15 (të gjitha të shqyrtuara) | Në bazë të Legjislacionit në fuqi në AKM | Nuk ka |
| **A. 1.14** | Pasqyrimi i tarifave të çdo shërbimi në QSU | Ministria e Shëndetësisë (MSH) | Korrik 2015 | I zbatuar | I zbatuar<br><br>Informacioni i publikuar on-line. Masë e përfunduar gjatë 6-mujorit të parë 2016. Transparence sa i perket tarifave te sherbimeve | Ndër hapat e ardhshëm përmendet mbajtja e perditesuar e tarifave te percaktuara, si ne faqen ëeb ashtu | Buxheti i disbursuar për realizimin e kësaj mase përbëhet vetëm nga kostot administrative |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | QSUT. | dhe ato te vendosura ne recepsione QSUT. | të cilat janë të mbuluara nga Buxheti i Shtetit. |
| **A. 1.15** | Mirëmbajtja e Regjistrit të Zhvillimit të Territorit në lidhje me sigurinë e hedhjes së të dhënave, nga përdoruesit e ndryshëm dhe përditësimi i saj | AKPT | 2015 | I zbatuar | Me hyrjen në fuqi të Ligjit 28/2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", të ndryshuar", AKPT, nuk është më autoritet përgjegjës për zhvillimin e territorit por për planifikimin e territorit. Gjithashtu, koncepti i Regjistrit të integruar të Territorit ka ndryshuar, duke ndarë në dy sisteme të veçanta: E- lejet dhe Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit. Me krijimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, me VKM nr.725, datë 02.09.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të AZHT", përgjegjësitë në fushën e zhvillimit të territorit dhe mbikqyrjen e sistemit elektronik e-leje, i ka AZHT. Regjistrit të ri (RKPT), do të nxisë më shumë transparencën në çështjet e planifikimit, pasi do të ketë fokus vetëm në proçeset e planifikimit të territorit. | Funksionimi i RKPT Regjistri Kombëtar i Planifikimit të Territorit për botimin e dokumenteve të planifikimit nga autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit | |
| **A. 1.16** | Përmirësimi i metodologjisë për përcaktimin e kategorive në fushën e licencimit profesional të pasurive të paluajtshme (studim, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim) | Ish-MZHU | 2015-2017 | I zbatuar | Janë përmbledhur dhe përpunuar gjithë mendimet dhe sugjerimet e ardhura nga grupet e interesit. Janë riformatuar kategoritë e licencimit në fushën e studim-projektimit dhe mbikëqyrje -kolaudimit të punimeve të ndërtimit, është hartuar drafti i rregullores dhe po pritet të merren mendimet nga ministritë e linjës. Ndërkohë, rregullorja e re që rregullon licencimin në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme është miratuar nga KM dhe pritet të hyjë në fuqi me botimin e VKM në fletoren zyrtare. Ky vendim ndryshon edhe mënyrën e aplikimit për | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | licencim, duke futur aplikimin on line, nëpërmjet sistemit informatik të integruar, që është realizuar si projekt pranë MZHU.<br>Eshte miratuar rregullorja e re e licencimit ne fushen e studimit e projektimit ne ndertim dhe mbikeqyrjes e kolaudimit te punimeve te zbatimit ne ndertim me **VKM nr. 943, date 28.12.2016.** Ne kete rregullore jane riformatuar kategorite e licencimit ne kete fushe, pasi jane konsultuar me gjithe grupet e interesit dhe institucionet universitare. Gjithashtu, me rregulloren e re, aplikimi per licencimin ne kete fushe, brenda 6 muajve nga hyrja ne fuqi e VKM, mund te kryhet nepermjet sistemit online, ne portalin e sherbimeve qeveritare ealbania , ose me poste, ndersa pas 6 muajve do te kryhet vetem online. | | |
| **A. 1.17** | Aksesi në portalin online e-Inspektimi | Inspektoriati Qëndror (IQ) | Maj 2015 | I parortuar | | | |
| **A. 1.18** | Publikimi i kritereve dhe kushteve të përcaktura në VKM "Për testimin dhe rekrutimin e Inspektorëve" | Inspektoriati Qëndror (IQ) | 2015 | I paraportuar | | | |
| **A. 1.19** | Transparencë për alokimin e fondeve të menaxhuara nga AIDA | AIDA | Çdo vit | I zbatuar | AIDA në mbështetje të NVM-ve Shqiptare me qëllim rritjen e konkurrueshmërisë së tyre, forcimin e kapaciteteve prodhuese, dhe daljen e tyre në treg, për vitin 2017 menaxhon 5 skema financiare nga buxheti i shtetit që janë : Fondi Shqiptar i Konkurrueshmërisë, Lekë 28.000.000, Fondi I Inovacionit LEKË E 10.000.000 , Fondin I Ekonomisë Kreative (Artizanatit) Lekë 10.000.000 , Fondi Start – up Lekë 10.000.000 , dhe Fondi për SME-të në zonat turistike/historike Lekë 10.000.000.Lidhur | Për zbatimin e masës në vazhdim do të ndërmerren hapat e nevojshme per publikimin ne web dhe fb të rezultateve nga mbledhjet e komisionit te fundit për të gjithë fondet. | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | me transparencën për alokimin e fondeve të buxhetit të menaxhuara nga AIDA për periudhën Korrik - Nëntor 2017, në faqen e ëebsite janë publikuar kushtet, afatet dhe kriteret e aplikimit per çdo fond të administruara nga Institucioni ynë. Për çdo person të interesuar si dhe bizneset qoftë person fizik apo juridik, nëpermjet linkut që ofrohet mund të informohen duke aksesuar të gjithë informacionin e nevojshem, për kriteret dhe mënyrën e aplikimeve, llojin e formularëve, të publikuar në faqen e internetit : http://aida.gov.al/faqe/fondet-e-aidas dhe http://aida.gov.al/faqe/arritjet-me-fondet-e-aida<br>Në mënyrë periodike pas cdo mbledhje komisioni të Vlerësimit të Fondve janë bëre publike nr aplikuesve dhe fituesit për çdo fond sipas sektorit dhe qarkut. http://aida.gov.al/neës/shpallen-fituesit-e-fondit-të-konkurrueshmerise-2017<br>2016 - http://aida.gov.al/neës/mblidhet-komisioni-i-aprovimit-të-grantit-për-fondin-e-konkurrueshmërisë-2016.Për periudhën Janar - Nëntor 2017 Totali subjekteve që kanë aplikuar për të gjitha fondet 57<br>Kompani të Suportuara nga AIDA me fondet Grant 28<br><br>Gjithashtu nëpermjet kontakteve dhe njoftimeve me email jane informuar një numër i kondisiderueshëm organizata dhe Shoqata biznesi ( 8 organizata dhe shoqata biznesi ) të cilat ia transmetuar anëtaresisë tyre duke i publikuar dhe në web e tyre. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 1.20** | Transparencë në fondet që alokohen për projektet kulturore | Ministria e Kulturës (MK) | Çdo vit | I zbatuar | Janë bërë transparente thirrjet për projekte, kriteret, shpalljen e projekteve fitues dhe emrat përkatës. Në çdo rast nga ana e Ministrisë së Kulturës të gjithë hapat e procesit të projekteve në art kulturë dhe trashëgimi kulturore bëhen publike në faqen zyrtare të MK. Për këtë përiudhë linku numër 1. http://www.kultura.gov.al/al/kërko?s=fituesit . Linku numër 2. http://ëëë.kultura.gov.al/al/neësroom/njoftime/thirrje-për-projekte-ekspozita-xvi-nderkombetare-e-arkitektures-bienale-e-venecias-2018. Për informacion lutem mbani parasysh edhe kete link: http://ëëë.kultura.gov.al/al/neësroom/lajme/thirrja-për-projëkt-propozime-për-vitin-2017-projektet-e-përzgjedhura-për-mbështetje-në-art-kulturë-dhe-trashëgimi-kulturore | Për cdo rast për hapje të thirrjeve për projekte do të ndiqet e njejta proçedurë transparente e konsoliduar tashmë në Ministrine e Kulturës. | |
| **A. 1.21** | Publikimi online i komponentëve të Shërbimit Këshillimor Publik (Ekstensioni Bujqësor) | Ish-Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) | Dhjetor 2015 | I pazbatuar | Mbyllja e platformës "Rrjeti i Inovacionit për Kërkim dhe Këshillim Bujqësor'', nuk mundësoi rifreskimin e të dhënave. Që prej vitit 2016 dhe deri tani nuk u mundesua risreskimi i kesaj platforme.<br>Për këtë arsye Specialiste të Sektorit të Këshillimit dhe Informacionit Bujqësor në Drëjtorinë e Programeve të Zhvillimit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit *Rural gjykojnë së këto tregues duhet të hiqen fare nga matrica për arsyen se nuk kane lidhje me të.* | | |
| **A. 1.22** | Krijimi në QSUT i qëndrës së informimit të publikut | Ish-Ministria e Shëndetësisë (MSH) | 2015 | I zbatuar | Masë e realizuar që në raportimin e vitit 2015. Mbi 9000 prenontime konsultash në linjën 08002828 si dhe prezenciale / mbi 3500 përfitues shërbimesh të ndryshme. | Do të vazhdojë proçesi | pa kosto shtesë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 1.23** | Publikimi periodik i projekteve përfshirë edhe fondin, aktivitetet si edhe vendet vakante dhe kriteret e konkurrimit për çdo projekt të financuar nga donatorë. | Ish-MMSR | 2015-2017 | I zbatuar | Gjate kësaj periudhe në Prill 2017 është realizuar indikatori i Bankës Botërore në lidhje me Pilotimin e modelit të ri social, për sistemin e ri të vleresimit të aftësisë së kufizuar (PAK) në vlerën 2,5 milion euro. | Shtrirja e skemës së re të Ndihmës Ekonomike në të gjithë vendin, duke filluar nga 1 Janar 2018. | |
| **A. 1.24** | Publikimi në faqen e internetit të MZHU i emrave dhe subjekteve që disponojnë liçenca në fushën e studim e projektimit dhe mbikëqyrje e kolaudimit, si dhe liçenca profesionale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme | Ish-MZHU | 2015-2017 | I zbatuar | Deri ne shtator 2017 Lista e individëve dhe subjekteve të licencuara në fushën e studim-projektimit dhe mbikëqyrje kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, si dhe në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme, ka qene e publikuar në faqen zyrtare të MZHU dhe është e aksesueshme nga të gjithë qytetarët. Bazuar ne **VKM nr. 943, date 28.12.2016.** aplikimi per licencimin ne kete fushe, brenda 6 muajve nga hyrja ne fuqi e VKM, mund te kryhet nepermjet sistemit online, ne portalin e sherbimeve qeveritare ealbania , ose me poste, ndersa pas 6 muajve do te kryhet vetem online. | | Pa kosto |
| **A. 1.25** | Publikimi në faqen e internetit të MZHU i dokumentacionit të plotë për aplikim për liçenca në fushën e studim e projektimit dhe mbikëqyrje e kolaudimit, si dhe liçenca profesionale në fushën e vlerësimit të pasurive të paluajtshme | Ish-MZHU | 2015-2018 | I zbatuar | I gjithe informacioni publikohej on line nepermjet protalit e-abania.<br><br>Deri ne shtator te 2017 Faqja e internetit të MZHU , http://www.zhvillimiurban.gov.al/eshte perditesuar me gjithe informacionin dhe dokumentacionin e nevojshem per aplikimin per licence, sipas rregulloreve te reja te miratuara, | | Pa kosto |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 1.26** | Krijimi i një aplikacioni për AKPT dhe Regjistrin e Planifikimit të Territorit dhe hartën GIS të tij | AKPT | 2015-2016 | Pjesërisht i zbatuar | 1. Në zbatim të ndryshimeve ligjore në fushën e planifikimit, po reflektohen ndryshimet në sistemin elektronik e-planifikimi.<br>2- AKPT po kryen testimin e funksionalitetit të sistemit e-planifikimi, sipas 6 dokumenteve të planifikimit për secilin autoritet përgjegjës të planifikimit në nivel qëndror dhe vendor. 3.Është në proçes hartimi i VKM për Rregulloren e Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit. | 1- Testimi i sistemit e-planifikimi për autoritetet kombëtare dhe vendore të planifikimit.<br>2- Miratimi i Rregullores së Funksionimit të Regjistrit Kombëtar të Planifikimit të Territorit. | |
| **A. 1.27** | Analizimi dhe raportimi publik i rezultateve nga "Formulari i Klientit" dhe rubrika "Sondazh" që përdoret nga blerësit (subjektet) e standardeve. | Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit | Në mënyrë periodike 6 mujore | I zbatuar | Nga sondazhi i 6 mujorit të dytë të 2017 rezulton se: 12 % e të anketuarëve kërkojnë të rritet shpejtësia e shërbimit; Rreth 16 % e të anketuarëve kërkojnë të rritet kompetenca; Rreth 28 % e të anketuarëve kërkojnë të rritet cilësia e standarteve që shesim; Rreth 28 % e të anketuarëve kërkojnë të përmirësohet mënyra e pagesës. Rezultati është publikuar në:https://www.dps.gov.al | | |
| **A. 5.9** | Zbatimi i rekomandimeve të GRECO lidhur me deklarimin dhe kontrollin e pasurive dhe konfliktin e interesave ne fushat e parlamentarëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve | Parlamenti | 2016 | Pjesërisht i zbatuar | Gjatë legjislaturës së kaluar, Kuvendi i Shqipërisë nuk mundi të miratojë Kodin e Sjelljes së Deputetëve të depozituar si nismë deputetësh.<br>Në legjislaturën e re, Projekti i Kodit të Sjelljes së Deputetëve u ridepozitua më 4.10.2017 firmosur nga një grup deputetësh.<br>Projektvendimi u përfshi në programin e punimeve dhe kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe iu kalua Këshillit të Rregullores Mandateve dhe Imunitetit, si organ përgjegjës, për shqyrtim dhe miratim. Puna për projektkodin vijon të jetë në proces në grupin e punës për të bërë reflektimin përfundimtar të propozimeve në projektkod.<br>Projektvendimi u caktua | Do vazhdojë gjatë 2018 | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | në Kalendar për shqyrtin në seancë plenare në rendin e ditës të datës 21.12.2017 por nuk u miratua serish. | | |
| **A. 5.10** | Përmirësimi i vendimit të KLD lidhur me ushtrimin e veprimtarisë akademike të gjyqtarëve (mësimdhënia) me qëllim shmangjen e konfliktit të interesave | KLD | 2015 | I zbatuar | Masë e përfunduar që në vitin 2015. | | |
| **A. 5.11** | Akte nënligjore të miratuara që detajojnë kërkesat e ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave për fusha të rëndësishme dhe komplekse për korrupsionin, si konçesionet dhe partneritet publik-privat. | ILDKPKI | 2016 | I pazbatuar | ILDKPKI nuk është instituconi përgjegjës për zbatimin e kësaj mase. Për këtë arsye duhën bërë ndryshimet përkatëse gjatë proçesit të rishikimit të PV. | Nevojitet identifikimi i institucionit përgjegjës si dhe rishikimi i masës në tërësi | |
| **A. 5.12** | Rritja e kapaciteteve dhe strukturave të administratës/autoriteteve përgjegjëse për të zbuluar, trajtuar dhe zgjidhur konfliktin e interesave rast pas rasti | ILDKPKI | 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Gjatë përiudhës së raportimit ka vijuar zbatimi i aktiviteteve konkrete sipas parashikimeve në projektin e binjakezimit ku ka ndërhyrje konkrete në fushën e parandalimit të konfliktit të interesave dhe rritjes së kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse dhe stafit të ILDKPKI mbi zbatimin e ligjit të konflikit të interesave. Në nëntor 2017 grupi i ekspertëvë teknikë të projektit të binjakëzimit në bashkëpunim me ekspertët e ILDKPKI finalizoi propozimin me amendimet e ligjit për konfliktin e interesave. Në vijim të këtyre amendimeve, parashikohet ngritja e një grupi pune për të identifikuar apo plotësuar | Ngritja e grupit të punës për reflektimin e amendimeve shtesë përtej atyre të përgatitura nga ekspertet e projektit te binjakezimit; Rishikimi i manualit për konfliktin e interesave dhe miratimi I tij; organizimi I trajnimeve për stafin e ILDKPKI si dhe autoritetet përgjegjëse | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | me amendime të tjera përtej atyre që tashme janë punuar me ndihmën e projektit të binjakëzimit. Paralelisht është punuar nga nje grup tjetër ekspertësh mbi përmirësimin e manualit për konfliktin e interesave i cili pasi të përkthehet në gjuhën shqipe do të rishikohet nga ekspertet e ILDKPKI-së në mënyrë që të finalizohet dhe miratohet. Një tjetër aktivitet i parashikuar në projektin e binjakëzimit janë dhe sesionet e trajnimeve për punonjësit e ILDKPKI si dhe autoritetet përgjegjëse mbi zbatimin e ligjit te parandalimit të konfliktit të interesave. | | |
| **A. 5.13** | Mundësimi i deklarimeve on-line të pasurisë | ILDKPKI | Dhjetor 2016 | Pjesërisht i zbatuar | Referoju raportimit në masën A.5.5 dhë A.5.6 më siper | Kjo masë duhet të jetë pjesë e masës A.5.5 më sipër gjatë rishikimit të PV | |
| **A. 5.14** | Ndryshime ligjore lidhur me monitorimin e konfliktit të interesit | ILDKPKI | Mars 2016 | Pjesërisht i zbatuar | Në nëntor 2017 grupi i eksperteve teknike të projëktit të binjakëzimit në bashkëpunim me ekspertet e ILDKPKI finalizoi propozimin me amendimet e ligjit për konfliktin e interesave. Në vijim të këtyre amendimeve, parashikohet ngritja e një grupi pune për të identifikuar apo plotësuar me amendime të tjera përtej atyre që tashme janë punuar me ndihmën e projektit të binjakëzimit. | Ngritja e grupit të punës për reflektimin e amendimeve shtesë përtej atyrë të përgatitura nga ekspertet e projektit te binjakëzimit; Vazhdimin e marrëdhënieve me Parlamentin ku do të depozitohen dhe diskutohen këto ndryshime | |
| **A. 5.15** | Ndërtimi i regjistrit elektronik të interesave dhe shkëmbimi më i mirë i informacionit për kontrollin e konfliktit të interesave, sidomos në fushën e drejtësisë; | ILDKPKI | Qershor 2015 | I zbatuar | Nuk ka perditësimë nga viti i kaluar. Masa është e realizuar. | Sugjerohet nga ILDKPKI rishikimi i Masës: Masa është akvitet vijues që ka shërbyer për të njëjtin qëllim: në këtë rast bëhet fjalë për përmirësimin e sistemit të IT, i cili shërben për kryerjen e kontrollit të plotë nga inspektorët e ILDKPKI dhe të cilët trajtojnë gjatë këtij kontrolli dhe konflikin e interesave. Për | 25,200,000 Lekë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | rrjedhoje, ky regjister elektronik nuk mund të bëhet publik, sic është parashikuar në treguesit e zbatimit. Sistemi është funksional. | |
| **A. 6.1** | Propozimi dhe hartimi i ndryshimeve në ligjin për partitë politike dhe Kodin Zgjedhor në lidhje me financimin e partive politike, caktimin e afateve specifike për raportimet, uljen e vlerave limit të donacioneve. | KQZ | 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Në seancën plenare të datës 22 maj 2017 (sesion i jashtëzakonshëm), Kuvendi miratoi ligjin nr.90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar. Ligji hyri në fuqi menjeherë, në datë 22.02.2017.<br>Në muajin korrik 2017, KQZ përzgjodhi me short dhe emëroi 15 auditues ligjore për auditimin e fondeve te perfituara dhe te shpenzuara nga 18 parti politike pjesmarrëse në zgjedhjet e datës 25 qershor 2017. Në përfundim të verifikimit KQZ vendosi sanksion adminitrativ me gjobë për 7 parti politike, pasi nga raportet e monitorimit dhe raportet e auditimit rezultonte se këto parti kishin shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe Ligjit "Për partitë politike" për financimin e fushatës zgjedhore. Raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore dhe raportet e auditimit financiar më datë 12 dhjetor 2017 u publikuan në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së. | Është ngritur komisioni parlamentar për Reformën Zgjedhore. Reforma zgjedhore do të miratojë dhe ndryshimet në ligjin "Për partitë politike" dhe Kodin Zgjedhor për financimin e partive | |
| **A. 6.2** | Hartimi i akteve nënligjore për të bërë të zbatueshme dispozitat ligjore për financimin e partive politike, thjeshtëzimin e raporteve financiare dhe kërkesave për audit, raportimin, | KQZ | Prill 2015 | I zbatuar | KQZ në zbatim Kodit Zgjedhor me vendimin nr. 167, datë 21.04.2017, "Për miratimin e udhëzuesit dhe formatit të standartizuar të raportimit financiar të fushatës zgjedhore" miratoi formatin e standartizuar dhe udhëzuesin përkatës për mënyrën e raportimit financiar nga Partitë Politike.5 ditë përpara fillimit të fushatës zgjedhore të partive politike Kuvendi i Shqipërisë, miratoi ligjin | Pas miratimit të ndryshimeve ligjore KQZ do të miratojë aktët nënligjore. | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | publikimin e raporteve financiare | | | | nr. 90/2017, datë 22.05.2017 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.02.2000, “Për partitë Politike” i ndryshuar. Ligji 90/2017 përcaktoi detyrimin e KQZ-së për të nxjerrë aktet nënligjore jo më vonë se 5 ditë nga hyrja në fuqi e tij. Në zbatim të ligjit për partitë politike KQZ, miratoi tre udhëzime. Udhëzimet e KQZ-së kanë rregulluar në mënyrë normative marrëdhënie të tilla, si:<br>- Udhezimi nr.1, date 31.5.2017" Përdorimin e materialeve propagandistike dhe vendet për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore";<br>- Udhezimi nr. 2, datë 1.06.2017 "Miratimin e proçedurave dhe kritereve për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve financiar";<br>- Udhëzimi nr. 3, dt 1.6.2017 "Mënyrën e përllogaritjes së kostos financiare të veprimtarive, shërbimeve apo materialeve që do të përdoren për qëllime zgjedhore ose politike, nga partitë politike gjatë fushatës zgjedhore". | | |
| **A. 6.3** | Marrja e masave për krijimin e strukturës përkatëse në KQZ për kontrollin dhe verifikimin e raporteve të auditeve | KQZ | Dhjetor 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Njësia përgjegjese e institucionit të KQZ-së, në përputhje me procedurat e ligjit për nëpunësin civil, është në proçes të plotësimit të pozicionëve vakante për këtë strukturë. | Proçesi i rekrutimit përfundon brenda tremujorit të parë të vitit 2018.<br><br>Emërimi i dy spëcialiste dhe një shef sektori | |
| **A. 6.4** | Zhvillimi i procedurave për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të autorizuar për fondet vjetore / për zgjedhjet | KQZ | Mars 2015 Gusht 2015 Mars 2016 Gusht 2017 | I zbatuar | Me vendimin nr.374, datë 9.06.2017, KQZ përzgjodhi me short dhe emëroi 24 eksperte financiare për monitorimin e fushatës zgjedhore të 18 partive poltike pjesmarrëse në zgjedhjet e datës 25 qershor 2017.Me vendimin nr.559, datë 31.07.2017, KQZ përzgjodhi me short dhe emëroi 15 auditues ligjore për auditimin e fondeve te | Organizimi i shortit dhe emërimi i eskperteve kontabël për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike për vitin 2017 të | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | perfituara dhe te shpenzuara nga 18 parti politike pjesmarrëse në zgjedhjet e datës 25 qershor 2017. | | |
| **A. 6.5** | Verifikimi i të dhënave të raporteve të ekspertëve kontabël | KQZ | Dhjetor 2015 | I zbatuar | KQZ administroi raportet e auditimit dhe raportet e monitorimit dhe shqyrtoi konkluzionet e tyre në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore nga partitë politike në lidhje me financimin. Në përfundim të verifikimit KQZ vendosi sanksion adminitrativ me gjobë për 7 parti politike, pasi nga raportet e monitorimit dhe raportet e auditimit rezultonte se këto parti kishin shkelur dispozitat e Kodit Zgjedhor dhe Ligjit “Për partitë politike” për financimin e fushatës zgjedhore.Raportet e monitorimit të fushatës zgjedhore dhe raportet e auditimit financiar më datë 12 dhjetor 2017 u publikuan në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së. | Shqyrtimi nga KQZ në mbledhje publike i raporteve te auditimit. Publikimi në faqen zyrtare të KQZ-së të Raporteve të ekspertët kontabël | |
| **A. 6.6** | Marrja e informacionit nga bankat, pyetja e personave dhe subjekteve të ndyshëm, këqyrja e dokumentacionit pranë zyrave përkatëse të partive politike | KQZ | Nëntor / Dhjetor 2015/2017 | I zbatuar | Keto janë veprime të kryera nga ekspertët financiarë dhe ekspertët kontabël dhe pasqyruar në raportet e monitorimit dhe raportet e auditimit. | Këto janë veprime të kryera nga ekspertët kontabël dhe të pasqyruara në raportet e auditit. | |
| **A. 6.7** | Studim mbi parashikimin ligjor të mundshëm për mundësinë ankimimit të palëve të treta për shkelje të pretenduara të rregullave të financimit të partive politike | Parlamenti | 2016 | I zbatuar | Në sajë të marrëveshjes politike të datës 17 Maj 2017, anëtarët e opozitës në Komisionin e Posacëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore u rikthyen në këtë Komision dhe në mbledhjen e datës 22 Maj 2017, së bashku me anëtarët e mazhorancës në Komision miratuan me konsensus tre projektligjet e propozuara në kuadër të reformës zgjedhore: projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 27.1.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"; projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar" dhe projektligjin "Për një ndryshim në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Në seancën e jashtëzakonshme plenare të datës 22 Maj 2017, Kuvendi miratoi me konsensus të gjerë tre projektligjet e propozuara nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore: ligjin nr. 89/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, "Kodi penal i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar"; ligjin nr. 90/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8580, datë 17.2.2000, "Për partitë politike", të ndryshuar" dhe ligjin nr. 91/2017 "Për një ndryshim në ligjin nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar". Në legjisalturën e re, me vendimin nr. 102/2017, datë 13 tetor 2017 Kuvendi miratoi me konsensus ngritjen e komisionit të posaçëm parlamentar "Për realizimin e reformës zgjedhore".<br>Komisioni ka për detyrë hartimin e ndryshimeve të kuadrit ligjor zgjedhor për trajtimin e rekomandimeve të raporteve të OSBE/ODIHR-it për tre zgjedhjet e fundit të viteve 2013, 2015 dhe 2017, të institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet dhe të propozimeve të partive politike që në zgjedhjet e fundit kanë marrë secila jo më pak se 1 për qind të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvendin. Komisioni drejtohet nga | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | dy bashkëkryetarë, një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike dhe ka në përbërjen e tij 18 anëtarë. Anëtarësia e Komisionit formohet me pjesëmarrjen e partive që kanë përfaqësim parlamentar, me përbërje të barabartë mes shumicës dhe pakicës.<br>Sipas vendimit të krijimit, Komisioni e ushtron veprimtarinë për një afat 6-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi, por në rast nevoje, me kërkesë të arsyetuar të bashkëkryetarëve,<br>Kuvendi, me vendim të veçantë, vendos zgjatjen e afatit të ushtrimit të veprimtarisë së Komisionit.<br>Instrumenti i realizimit të objektivit të këtij komisioni është ekspertiza vendase dhe ajo e huaj. Pranë Komisionit, me vendim të tij, është ngritur një grup ekspertësh teknik, si përfaqësues të subjekteve zgjedhore parlamentare. Grupi i ekspertëve ka në përbërje të tij 8 ekspertë, 4 përfaqësues të mazhorancës dhe 4 të opozitës<br>Gjithashtu, janë të ftuar të ndjekin dhe të japin asistencë dhe ekspertizë teknike në punimet e Komisionit dhe të grupit të ekspertëve teknikë të ngritur pranë tij dhe Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, ekspertë të OSBE/ODIHR-it, Këshilli i Europës, ekspertë të Komisionit të Venecias, si dhe përfaqësues dhe/ose ekspertë të BE-së dhe SHBA-ve.<br>Mbledhja për konstituimin e Komisionit u zhvillua në datën 10 nëntor 2017, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit. Mbledhja e rradhës u zhvillua në datën 1 dhjetor 2017. Në këtë mbledhje Komisioni mori vendim për ngritjen dhe përbërjen e grupit të ekspertëve, duke u ngarkuar detyrën të | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | krijojnë një agendë të punës, duke listuar çështjeve prioritare, sipas tematikës së tyre. | | |
| **A. 7.1** | Krijimi i një strukture për kryerjen e analizave të riskut në lidhje me korrupsionin mbi bazën e inspektimeve dhe hetimeve | MPB | Qershor 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Edhe ky objektiv është për ndjekje në vazhdimësi gjatë vitit 2017 në funksion të përmbushjes së një prej objektivave të veprimtarisë së SH.Ç.B.A-së, që lidhet me analiza e rekomandime mbi bazën e protokolleve të inspektimit dhe raporteve të hetimit penal, për strukturat objekt i punës së Shërbimit tonë. | Në fillim të vitit 2018, në faqen e internetit të Shërbimit, www.shcba.gov.al do të publikohet Raporti Vjetor i Punës për vitin 2017, ku do të pasqyrohen gjetjet dhe rekomandimet e dhëna për strukturat, objekt i veprimtarisë së SH.Ç.B.A-së bazuar tek protokollet e inspektimit dhe raportet e hetimeve penale. | Buxheti i Shtetit |
| **A. 7.2** | Rishikimi i dokumentit të vlerësimit kombëtar të riskut për PP/FT. | DPPPP | Qershor 2015 | I zbatuar | Masë e zbatuar që në vitin 2015. | | |
| **A. 7.3** | Analizë risku për vonesat në gjykim ndaj gjyqtarëve të gjykatave të shkallës së parë dhe apeleve | KLD | 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Për periudhën e raportimit KLD ka operuar bazuar në dispozitat tranzitore. Megjithë ngarkesën e madhe që Inspektorati i KLD ka pasur si rrjedhojë e intensifikimit të ritmeve për vlerësimin profesional të gjyqtarëve dhe në mbështetje të vlerësimit kalimtar - Veting-ut, komunikimi me gjykatat ka vijuar të jetë i rregullt. | | |
| **A. 7.4** | Analizë risku për përjashtimin e gjyqtarëve nga gjykimi dhe për procesin e delegimeve | KLD | 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Kuadri i ri ligjor i miratuar, konkretisht ligji nr 96, dt 6/10/2016 per statusin e gjyqtareve, parashikon një sistem tjetër delegimi të gjyqtarëve në gjykata, rregullat e të cilit sistem do të miratohen nga Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, i parashikuar për tu krijuar. | Pritet krijimi i KLGJ | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 7.5** | Inspektimi tematik për të analizuar ecurinë e efiçencës dhe efektivitetit të hetimeve penale kundër krimit ekonomik dhe financiar (korrupsioni) në gjykata | KLD | 2015 | I pazbatuar | KLD vlerëson që kjo çështje të trajtohet nga Prokuroria pasi nuk janë hetimet penale kompetencë e institucionit të KLD. Rekomandohet rishikimi i institucionit pergjegjës të Masës | | |
| **A. 7.6** | Analizë risku për personat me liri të kufizuar të cilët tentojnë/ndikojnë në përfshirjen e punonjësve të policisë së burgjeve në akte korruptive | MD | 2016 | I zbatuar | Në bashkëpunim me ekspertët anglez të projektit të binjakëzimit për reformen në sistemin e burgjeve, u hartua instrumenti për vleresimin e rrezikshmerisë të burgosurve. Stafi i burgjeve u trajnua nga Sektori i Çështjeve Sociale ne DPB, në lidhje me zbatimin në praktikë të instrumentit. Rreth 40 staf multidisiplinar u trajnua gjatë vitit 2017. | Trajnimi i gjithë stafit përgjegjës për zbatimin e instrumentit në të gjitha IEVP gjatë 2018. | Kosto administrative |
| **A. 7.7** | Planifikime online të koordinuara të inspektimeve bazuar në analizën e riskut | Inspektoriati Qendror (IQ) | 2015 | I paraportuar | | | |
| **A. 7.8** | Hartimi dhe miratimi i planit vjetor të inspektimeve mbi bazën e kritereve të mirëpërcaktuara dhe raportimi i përvitshëm mbi rezultatet e inspektimit vjetor | Ish-Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)<br><br>MBZHR | 2015-2017 | Pjesërisht i zbatuar | Rekomandimet dhe masat e dhëna kanë dhënë impakt pozitiv në përmirësimin e punës në drejtim të menaxhimit të fondeve buxhetore, të aseteve, të ardhurave dytësore si edhe në realizimin e objektivave të përcaktuara për zhvillimin e sektorit bujqesor, blegtoral dhe agroushqimor<br>- Gjatë vitit 2017, është hartuar plani vjetor i auditimit i miratuar nga Ministri me shkresën nr 7744 prot datë 12.10.2016. Janë planifikuar gjithsejt 18 misione auditimi, për vitin 2017, realizuar në fakt 19 misione, në proçes auditimi 1 subjekt (Fondet e BE). Jane evaduar gjithsejt 19 dosje auditimi, 2 prej të cilave i përkasin vitit 2016. | Do të bashkëpunohet ngushtë me ish-Ministrine e Financave dhe DAP për ngritjen e njësisë së inspektimit financiar. Janar-Dhjetor 2018 pritet te jetë afati i zbatimit. | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Për 6-mujorin e dytë janë planifikuar 9 misione auditimi realizuar në fakt 11 misione auditimi, evaduar në fakt 11 misone, nga të cilat dy misione auditimi janë të pa planifikuara, por janë kryer me Urdhër të posaçëm të Ministrit. Rekomandime gjithsejë 127, për masa organizative, disiplinore dhe çdëmtimi. Zbulimet në total 3.687 mijë lekë. Inspektime financiare, nuk ka pasur, pasi MBZHRAU nuk ka njësi të inspektimit financiar. Në vijimësi do të kërkohet krijimi i njësisë së inspektimit financiar dhe do të bashkëpunohet me njesime e inspektimit financiar në ish-Ministrinë e Financave. Deri në krijimin e Njësisë së Menaxhimit Financiar, do të bashkëpunohet dhe bashkërendohet me Njësinë e Menaxhimit Financiar në Ministrinë e Financave. | | |
| **A. 7.9** | Krijimi i sistemit të kryqëzimit dhe vlerësimit të të dhënave që vijnë nga kontrollet bazuar mbi Ligjin Nr. 10465 " Për Shërbimin Veterinar" | Ish-Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)<br><br>MBZHR | 2015-2017 | Pjesërisht i zbatuar | Kryerja e 3235 kontrolleve /monitorimeve nga Shërbimi Veterinar Rajonal në të gjithë vendin kanë ndikuar në përmirësimin e procesit të identifikimit dhe sistemin "RUDA", lëvizjes së kafshëve të gjalla, në procesin e vaksinimit dhe të zinxhirit ftohës të vaksinave, monitorimit/kontrollit dhe/ose parandalimit të përhapjes së sëmundjeve zoonotike apo LSD, mbajtjes së dokumentacionit dhe plotësimin të kërkesave në përputhje me legjislacionin veterinar të fermave që mbarështojnë kafshë të gjalla, subjekteve të tregëtimit të kafshëve të gjalla,tregje të kafshëve të gjalla, qendrat e grumbullimit të lëkurëve dhe depo/farmaci veterinare. | Vijimi i të gjitha aktiviteteve gjate 2018. | Buxheti i shtetit për Sigurinë Ushqimore dhe Mbrojtjesn e Konsumatorit |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 7.10** | Përgatitja e Planeve të Monitorimit në lidhje me zbatimin e procedurave të prokurimit publik, nga ana e autoriteteve kontraktore, duke marrë në konsideratë vlerën e kontratave përkatëse publike | APP | Çdo fund viti | I zbatuar | Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2017 APP ka monitoruar kryesisht 44 proçedura prokurimi në 34 Autoritete Kontraktore. Gjithashtu, APP ka marrë në shqyrtim edhe 34 raporte auditi të dërguara nga institucione të ndryshme audituese, nëpërmjet të cilave janë shqyrtuar 289 proçedura prokurimi. Numri total i proçedura të prokurimit të monitoruara nga APP është 333. Problematikat e evidentuara gjatë këtij proçesi vazhdojnë të mbeten të njejtat, konkretisht (i) Përdorim i gabuar i proçedurës negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës; (ii) përllogaritje e gabuar e fondit limit; (iii) problematika në hartimin e specifikimeve teknike; (iv) kualifikim i gabuar i operatorëve ekonomike etj. | Gjatë vitit 2018 do të vijohet me monitorimin e procedurave të prokurimit dhe të raporteve te auditit. | |
| **A. 7.11** | Përfundimi i raundit të dytë të vlerësimit të gjyqtarëve për periudhën 2007-2009 | KLD | Brenda vitit 2015 | I zbatuar | Raundi i dytë,për periudhën 2007-2009, përfundoi në Nëntor 2017 dhe vlerësoi 296 gjyqtarë. | | |
| **A. 7.12** | Zhvillimi i raundit të tretë të vlerësimit të gjyqtarëve sipas parashikimeve te ligjit | KLD | 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Është në proces vlerësimi profesional i gjyqtarëve për periudhën 2010 – 2012. Deri më tani ka përfunduar ky vlerësim për 15 gjyqtarë. | | |
| **A. 7.13** | Hartimi dhe miratimi i vendimit për rregullat e detajuara të vlerësimit të kryetarëve të Gjykatave | KLD | 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Me miratimin e Ligjit nr. 96/2016 date 06.10.2016 ndryshon kuadri ligjor qe rregullon vlerësimin e kryetarëve të gjykatave dhe të gjykatësve. Vendimet përkatese do të miratohen nga KLGj. | Vendimet përkatese do të miratohen nga KLGj. | |
| **A. 7.14** | Raundi i parë dhe i dytë i vlerësimit të kryetarëve të gjykatave | KLD | 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Deri në 10 Shkurt 2017 për sa i përket 6-M të dytë të vitit 2016 ka përfunduar vlerësimi për 3 Kryetarë gjykatash, për dy të tjerë është përpiluar raporti final dhe pritet diskutimi në KLD, 8 akte vlerësimi janë në proçes finalizimi nga inspektoriati. | Me konstituimin e KLGJ dhe inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë vleresimet përkatëse dhe vendimet respektive do te miratohen nga | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Me konstituimin e KLGJ dhe inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë vleresimet përkatëse dhe vendimet respektive do te miratohen nga këto institucion. | këto institucion. | |
| **A. 7.15** | Rishikimi i manualit specifik të auditimit për përmirësimin e procedurave për rritjen e shpeshtësisë dhe efikasitetit të informacionit në auditim. | MPJ | 2015 | I paraportuar | | | |
| **A. 7.16** | Ngritja e një sistemi të qëndrueshëm për parandalimine korrupsionit në Sistemin e Burgjeve | MD | 2015 | I zbatuar | Kjo masë është realizuar prej vitit 2015-2016. Bordi është ngritur në bazë të Urdhrit nr. 11529, datë 10.12.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe ka përcaktoi objektiva afatgjatë të punës, të cilat synojnë ndërtimin e një sistemi efektiv e transparent të menaxhimit të punës në DPB. Urdhri parashikonte kryerjen e inspektimeve periodike dhe në raste të posaçme, kur ka informacion për akte korruptive, duke patur parasysh edhe detyrimet që rrjedhion në zbatim të kuadrit ligjor dhe atij nënligjor aktual mbi të cilin operohet në sistemin e burgjeve. Bordi filloi aktivitetin e punës në janar të 2015. | Gjatë 2018 do te vzahdoje forcimi i kapaciteteve të strukturës që do të trajtojnë çështjet e informatorëve të rasteve të korrupsionit sipas parashikimeve ne masën A. 4.12 | Kosto administrative |
| **A. 7.17** | Rishikimi i kuadrit ligjor lidhur me inspektimin financiar publik | Ministria e Financave (MF) | | I zbatuar | Nuk ka ndryshime, përfunduar në masën 100% brënda 2016. | nuk ka | |
| **A. 7.18** | Rritja e kapaciteteve të stukturave të administratës lidhur me rolin e auditit të brendshëm. | Ish-Ministria e Financave (MF)<br><br>MFE | 2015-2016 | I zbatuar | MF: Në zbatim të pikës 10, të nenit 13 dhe pikës 8, të nenit 19 të ligjit nr. 60/2016, “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, Kodin e Procedurave Administrative, VKM-në nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet | MF: nëse do te kete raste, ato do te shqyrtohen dhe raportohen menjehere<br>DPD: Do të vijoje trajnimi I si nga MF dhe administrate doganore, me fokus auditimin e fondeve te BE, njohja me legjislacionin e ri | Pa Kosto shtese |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | publike, në zbatim të ligjit nr.60/2016, "Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve", si dhe udhëzimeve dhe akteve të tjera nënligjore të miratuara nga ILDKPKI-ja, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar me urdhër të Ministrit nr. 13 datë 06.02.2017 rregulloren e brendshme të posacme "Për procedurën e shqyrtimit te hetimit administrativ të sinjalizimit, mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit dhe mbrojtjes nga hakmarrja në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë"a. Për periudhën e mësipërme nuk ka patur raste të hetimeve administrative për sinjalizimet. DPD: Janë zhvilluar nga 40 orë trajnim secili, për 7 auditues të brendshëm, që kanë pasur në fokus vlerësimin e kontrollit të brendshëm, auditimin dhe hetimin e mashtrimit, vlerësimin e riskut, auditimin e sistemeve të IT, auditimin e përformances. | doganor, rregullat e perfitimit te origjines preferenciale etj. | |
| **A. 8.1** | Përfshirja e Manualit për corruption proofing të hartuar nga PACA dhe përfshirja e tij në manualin e rishikuar për hartimin e legjislacionit (në kuadër edhe të rishikimit të tij pas miratimit të ligjit mbi konsultimin publik) | MD | Qershor 2016 | I pazbatuar | Sikurse është kërkuar në vazhdimësi kjo masë duhet të rishikohet | | |
| **A. 8.2** | Miratimi i VKM për zbatimin e metodologjisë corruption proofing | MD | 2016 | I pazbatuar | Sikurse është kërkuar në vazhdimësi kjo masë duhet të rishikohet | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 8.3** | Hartimi i metodologjisë mbi corruption proofing dhe zbatimi i saj | NjL-KM | 2017 | I pa zbatuar | Sikurse është kërkuar në vazhdimësi kjo masë duhet të rishikohet | | |
| **A. 8.4** | Analiza e kuadrit nënligjor të KLD-së, duke përdorur metodën corruption-proofing dhe nxjerrja e rekomandimeve për përmirësimin e akteve nënligjore | KLD | Qershor 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Konstituimi i KLGJ-së dhe miratimi i akteve nënligjore nga kjo strukturë do të bëjë të mundur edhe një analizë më të thelluar dhe më të saktë në këtë drejtim. | Konstituimi i KLGJ-së dhe miratimi i akteve nënligjore nga kjo strukturë do të bëjë të mundur edhe një analizë më të thelluar dhe më të saktë në këtë drejtim. | |
| **A. 8.5** | Reflektimi i rekomandimeve të kësaj analize në vendimet normative të KLD-së, pas miratimit të ligjit mbi KLD nga Kuvendi | KLD | Sipas afateve të caktuara nga analiza | Pjesërisht i zbatuar | Kjo masë do të duhet të ndiqet nga institucioni i ri që pritet të krijohet: KLGJ. | Kjo masë do të duhet të ndiqet nga institucioni i ri që pritet të krijohet: KLGJ. | |
| **A. 9.1** | Zbatimi i proçedurave të testimit të integritetit në mënyrë të vazhdueshme në administrimin e doganave | DPD | 2017 (në vazhdim) | Pjesërisht i zbatuar | Janë kryer 2 Teste Integriteti nga ku rezultoi se proçedurat doganore janë kryer në zbatim të Kodit Doganor dhe Dispozitave Zbatuese. Nuk ka pasur nevojë për trajnime/masa ndaj punonjësve objekt i testeve. | Do kryhen 6 Teste Integriteti në lidhje me zbatimin e bazës ligjore mbi të cilën operon ADSH | Pa kosto shtese |
| **A. 9.2** | Përfshirja e pyetjeve që lidhen me integritetin në testimet për rekrutimin në administratën publike, si dhe kritereve për integritetin në publikimin e vendeve vakante | DAP | 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Gjatë kësaj periudhe nuk ka patur ndryshime. Për realizimin e kësaj mase Departamenti i Administratës Publike ka punuar ngushtë me ekpsertizën e ofruar nëpërmjet Projektit të Binjakëzimit, për të gjetur qasjen dhe mënyrën më të përshtatshme për të përfshirë këto tipologji pyetjesh në testimet hyrëse. | Pas miratimit të planit të ri vjëtor të rëkrutimit do të vijohet me përfshirjen e pyetjeve që lidhen me integritetin në testimet për rekrutimin në administratën publike, si dhe kriteret lidhur me integritetin në publikimin e vendeve vakante | |
| **A. 9.3** | Kryerja e testimit të integritetit në Polici | MPB | 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Mbi bazën e Urdhrit të Përbashkët të Përbashkët të Drejtorit të Përgjithshëm të SH.Ç.B.A-së dhe Drejtorit të Policisë së Shtetit nr. 136, datë 09.09.2016 “Për | Edhe ky objektiv është për ndjekje në vazhdimësi gjatë vitit 2018 në funksion të përmbushjes së një prëj | Buxheti i Shtetit |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | miratimin e manualit mbi procedurat dhe metodat e kryerjes së Testit të Integritetit" dhe Urdhrit të Përbashkët Nr. 61, datë 30.03.2017 "Për kryerjen e testimit të njohurive" është kryer testimi ndaj SPZ për njohjen e situatës në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër kanabisit" në qarqet Shkodër, Sarandë, Elbasan, Gjirokastër, Berat, Korçë, Durrës dhe Tiranë. Rezultatet e testimit janë në proces përpunimi. | objektivave të veprimtarisë së SH.Ç.B.A-së, që lidhet me analiza e rekomandime mbi bazën e protokolleve të inspektimit dhe raporteve të hetimit penal, për strukturat objekt i punës së Shërbimit tonë. | |
| **A. 9.4** | Rritja e kapaciteteve e institucioneve për sistemin e testimit të integritetit | ASPA | 2017 | I zbatuar | A.Zhvillimi i 11 trajnimeve mbi Antikorrupsionin dhe Mireqeverisjen ku u trajnuan 333 nepunes te Administrates Publike, konkretisht:<br>• 3 trajnime 2-ditore per nc te Administrates vendore-64 nc te trajnuar;<br>• 1 trajnim 2-ditor per nc te Ministrise se Ekonomise-6 nc te trajnuar;<br>• 6 trajnime 1-ditore per nepunesit ne periudhe prove, pjese e trajnimit te detyruar per Administraten vendore-236 te trajnuar;<br>• 1 trajnim 1-ditor, pjese e trajnimit te Prokurimit Publik-27 nc te trajnuar;<br>B. Shtese njohurish per trajneret e trajnuar te antikorrupsionin (ToT) mbi Ligjin e Sinjalizuesve. Trajnimi i 38 njesive te sinjalizimit, perfaqesues te njesive antikorrupsion ne institucionet e tyre. | Vijimi i misionit institucional për forcimin e kapaciteteve të zyrtarëve publikë të Administratës publike në lidhje me Antikorrupsionin, integritetin e qeverisjen e mire | |
| **A. 9.5** | Memorandum mirëkuptimi Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat me Shërbimin Doganor Shqiptar për shëmbimin e informacionit dhe | SHCBA | 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Memorandum mirëkuptimi Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat me Shërbimin Doganor Shqiptar për shkëmbimin e informacionit dhe kryerjen e testit të përbashkët të integritetit, është i miratuar në datën 22.07.2015 ndërmjet Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave. | Bashkëpunimi edhe gjatë periudhës analizuese është fokusuar në shkëmbimin e informacionit.<br>DPD: Do kryhet 1 Test Integriteti i përbashkët ndaj strukturave doganore dhe policore që operojnë në Pikat | Buxheti i Shtetit |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | kryerjen e testit të përbashket të integritetit | | | | DPD: Janë përgatitur draft-dokumente për kryerjen e Testeve të përbashkëta të integritetit. | e Kalimit Kufitar | |
| **A. 9.6** | Zbatimi i projektit "Mbështetje për Antikorrupsionin në Shqipëri" | ASPA | Dhjetor 2015 | I zbatuar | Për vitin 2017 është mundesuar Zhvillimi i 35 trajnimeve mbi Antikorrupsionin dhe Mireqeverisjen ku u trajnuan 994 nëpunës të Administratës Publike, dhe 5 përfaqësues të shoqatave të biznesit, konkretisht:<br><br>A.Në kuadër të projektit "Mbështetje për Antikorrupsionin në Shqipëri", bashkëpunim me OSBE-në:<br>• 4 trajnime 2-ditore për nc të Administratës vendore-81 nc të trajnuar në kuadër të projektit "Mbështetje për Antikorrupsionin në Shqipëri"<br>• 1 trajnim 2-ditor për nc të Ministrisë së Ekonomisë-6 nc të trajnuar në kuadër të projektit "Mbështetje për Antikorrupsionin në Shqipëri" dhe 1 trajnim 2-ditor për Shoqatat e Biznesit në kuadër të projektit "Mbështetje për Antikorrupsionin në Shqipëri"-5 të trajnuar; Aktivitetet e parashikuara në kuadër të projektit "Mbështetje për Antikorrupsionin në Shqipëri" janë përfunduar. ASPA do të vazhdojë të realizojë trajnime në kuadër të planit të trajnimit.<br><br>B. Zhvillimi i trajnimeve nga ASPA me kurrikula të integruara mbi çështjet e antikorrupsionit:<br>• 20 trajnime 1-ditore për nëpunësit në periudhë prove, pjesë e trajnimit të detyruar për Administratën vendore-650 të trajnuar;<br>• 5 trajnime 1-ditore, pjesë e trajnimit të Prokurimit Publik-128 nc të trajnuar; | "Vijimi i misionit institucional të ASPA-s për forcimin e kapaciteteve të zyrtarëve publikë në lidhje me Antikorrupsionin, integritetin e qeverisjen e mirë". | A. 13,720 Euro OSBE dhe 93,000 Lek ASPA<br><br>B. 2,080,000 Lek ASPA |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | •2 trajnime 1-ditore pjesë e Induction-Administrata Qëndrore- 54 nc të trajnuar;<br>Trajnimet do të vijjnë të zhvillohen në kuadër të planit të trajnimit të ASPA.<br><br>C.Trajnime të zhvilluara në sektorin e Shëndetësisë në bashkëpunim me projektin HAP-Ambasada Zvicerrane.<br>•2 trajnime 2-ditore me Drejtorite e Shendetesise te Qarqeve Fier dhe Diber -75 nc të trajnuar;<br><br>D. Shtesë njohurish për trajnerët e trajnuar të antikorrupsionin (ToT) mbi“Sinjalizimi dhe mbrojtja e sinjalizuesve – Njohje me kuadrin ligjor dhe zbatimin e tij”- bashkëpunim me PartneretShqiperi.<br>Trajnimi i 38 njesive te sinjalizimit, përfaqësues të njësive antikorrupsion në institucionet e tyre. Aktivitetet e parashikuara në kuadër të projektit janë përfunduar.<br><br>E.Konsultime me Projektin Twinning "Mbështetje në formulimin, koordinimin dhe zbatimin e politikave anti-korrupsion në Shqipëri" mbi bashkëpunimin me ASPA në lidhje me përmirësimin e kapaciteteve të autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e efektshëm të Ligjit për Konfliktin e Interesit. | | C.118,000 Lek HAP dhe 72,000Lek ASPA<br><br>D.1899 Euro Partneret Shqiperi |
| **A. 10. 1** | Ndërtimi i sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes në të gjitha Komisariatet e Policisë | PSH | Dhjetor 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Gjatë periudhës Korrik – Nëntor 2017, në lidhje me punën e bërë për implementimin e “Sistemit për Menaxhimin Policor të Çështjes”, janë realizuar këto aktivitete: 1. Ka përfunduar trajnimi i 660 punonjësve të policisë (i të gjitha niveleve dhe funksioneve) të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Korçë. | Shtrirja e projektit të Sistemit të Menaxhimit Policor të Cështjes në Drejtorite Vendore te Policisë Fier, Gjirokastër, Dibër dhe Kukës. | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 2. Ka filluar implementimi i "Sistemit për Menaxhimin Policor të Çështjes", në të gjitha strukturat policore në varësi të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Korçë. (Urdhër Nr.885, datë 24.08.2017, Për Fillimin e implementimit të "Sistemit për Menaxhimin Policor të Çështjes", nga ana e të gjitha strukturave policore të Drejtorisë Vendore të Policisë Korçë dhe Drejtorisë Vendore të Kufirit dhe Migracionit Korçë.)<br>3. Ka filluar dhe është në përfundim procesi i trajnimit të rreth 640 punonjësve të policisë (i të gjitha niveleve dhe funksioneve) të Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër dhe Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Shkodër. | | |
| **A. 10. 2** | Trajnimi i personelit të shërbimit mbi raportimin statistikor dhe analizimin e të dhënave statistikore të rasteve të korrupsionit | MPB | Sipas kalendarit deri në Dhjetor 2016 | Pjesërisht i zbatuar | Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, çdo muaj, publikon të dhënat statistikore lidhur me korrupsionin në buletinin mujor të Policisë së Shtetit. Të dhënat statistikore lidhen me numërin e veprave penale të referuara, numrin e hetimeve proaktive si dhe numrin e operacioneve policore. Gjatë periudhës Korrik-Nëntor 2017, nga strukturat për Hetimin e Korrupsionit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit janë referuar 456 vepra penale për korrupsion dhe krime në detyrë, ku në 145 raste po kryhen hetime proaktive për korrupsion dhe krime në detyrë dhe janë realizuar 21 operacione policore. Krahasuar me të njejtën periudhë të vitit 2016 janë referuar 57 vepra penale me shume, po kryhen hetime proaktive për 30 rastë më shumë, si dhe janë realizuar 6 operacione policore me pak. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 10. 3** | Finalizimi i arkitekturës së sistemit elektronik për statistikat, si dhe trajnimi i pikave të kontaktit që do të përdorin sistemin elektronik | Ish-MSHÇV | Qershor 2015 | I zbatuar | Masë ë zbatuar në vitin 2016 | | |
| **A. 10. 4** | Hartimi dhe nënshkrimi i Memorandumit të Bashkëpunimit me Prokurorinë e Përgjithshme për funksionalizimin e sistemit të ri | Ish-MSHÇV | Shkurt 2015 | I zbatuar | Mase e zbatuar ne vitin 2016 | | |
| **A. 10. 5** | Hartimi dhe miratimi i urdhrit për zbatimin/përdorimin e sistemit elektronik nga administrata gjyqësore | MD | Prill 2015 | I zbatuar | Kjo masë përmbyllur në vitin 2016 me publikimin e urdhrit në faqen zyrtare të MD në linkun http://www.drejtesia.gov.al/al/publikime/publikime/urdhri-i-ministrit-të-drëjtësisë-për-përcaktimin-e-rregullave-për-përdorimin-e-sistemit-elektronik-për-regjistrimin-dhe-gjurmimin-e-të-dhënave-mbi-rastet-e-korrupsionit-dhe-statistikave-të-harmonizuara | Gjate vitit 2018 do te vijoje Monitorimi i zbatimit të urdhrit (hartimi i raportit) duke qënë se ka ndryshuar institucioni që luan rolin e Koordinatorit Kombetar Kunder Korrupsionit | |
| **A. 10. 6** | Rishikimi i komunikimit të statistikave pas konsolidimit të sistemeve të ndryshme elektronike të menaxhimit të rasteve | PSH | 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Deri me tani eshte implementuar sistemi I menaxhimit te çeshtjes ne 7 Drejtori te Policise vendore | | |
| **A. 10. 7** | Hartimi i dokumentit për Projektin e Binjakëzimit IPA 2013. "Mbështetje për Luftën | Ish-MSHÇV | Shkurt 2015 | I zbatuar | Projekti u finalizua në shtator 2015 dhe procedurat e tenderimit përfunduan më 7 janar 2016. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Kundër Korrupsionit " | | | | | | |
| **A. 10. 8** | Fillimi zyrtar i zbatimit të projektit për IPA 2013 Twining Project "Support to the fight against corruption" | Ish-MSHÇV | Janar 2016 | I zbatuar | Masë e zbatuar në vitin 2016 | | |
| **A. 10. 9** | Organizimi dhe koordinimi i misioneve të ekspertëve të TAIEX mbi çështje që lidhen me funksionalizimin e strukturave kundër korrupsionit në Shqipëri. | Ish-MSHÇV | Dhjetor 2016 | I pazbatuar | MD nuk ka kryer aplikime për TAIEX gjatë vitit 2017 nisur nga përmbajtja e Projektit të Binjakëzimit në asistencën teknike nga KKK | | |
| **A. 10. 10** | Forcimi i masave antikorrupsion në kuadër të zbatimit të projektit të binjakëzimit "Mbështetje për Sistemin e Burgjeve dhe Shërbimin e Provës" | MD | 2015-2017 | I zbatuar | U hartua nga ekspertët e projektit të binjakëzimit një dokument për strategjinë kundër korrupsionit dhe i është paraqitur DPB. Gjithashtu, u punua për hartimin e dokumenteve për matjen e përformancës (Objektivat dhe Treguesit Kryesorë të Performancës) dhe e një sistemi të pavarur inspektimi. Ekspertët afat-shkurtër studiuan dhe rishikuan një model për matjen e performancës në sistemin e burgjeve. Disa nga përfitimet për krijimin e një strukture të përshtatshme dhe funksionale të vlerësimit të performancës përfshijnë: Llogaridhënia e drejtorëve; Të kuptuarit se cilat institucione kanë përformuar më dobët; Shpërndarje më e mirë e burimeve; Interpretim i duhur i të dhënave dhe analiza; Proçedura të përmirësuara të sigurisë; Integriteti i të dhënave | Forcimi masave antikorrupsion | Kosto administrative |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **A. 10. 11** | Rritja e kapaciteteve të Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit | Ish-MSHÇV<br><br>MD | 2016-2017 | I zbatuar | Gjatë periudhës Janar-Shtator 2017, KKK ka funksionuar me kapacitet të plotë.<br><br>Nga shtatori 2017, Ministria e Drejtësisë udhëheq koordinimin e politikave ne luftën kundër korrupsionit. Struktura kunder korrupsionit në Ministrinë e Drejtësisë është themeluar. Strukturat që do të merren drejtpërdrejt me anti-korrupsionin janë: i) sektori i antikorrupsionit, i përbërë nga 3 punonjës dhe që do të kontribuojë në zbatimin e projekteve të antikorrupsionit dhe do të koordinojë aktivitetet për të siguruar përparimin e dëshiruar për secilin projekt. . ii) Drejtoria e Programeve në Fushën e Drejtësisë e cila ka të drejtë të shqyrtojë Planin e Veprimit të Strategjisë Kombëtare Kundër-korrupsion për periudhën 2018-2020. Ka një sektor programesh në fushën e drejtësisë dhe anti-korrupsionit të përbërë nga 3 punonjës. Për më tepër, ekziston një Drejtori për Politikat dhe Strategjitë në Drejtësi, e cila do të koordinojë të gjitha institucionet pjesëmarrëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare kunder korrupsionit dhe planin e saj të veprimit.<br><br>Dy përfaqësues nga Kabineti i Ministrit janë caktuar për fushën e Antikorrupsionit. | Gjatë vitit 2018 do të vazhdojë rritja e kapaciteteve të KKK mbështetur dhe nga projekti i BE “Mbështetje kundër korrupsionit” | |
| **A. 10. 12** | Rritja e kapaciteteve të pikave të kontaktit kundër korrupsionit lidhur me masat antikorrupsion dhe monitorimin e tyre | Ish-MSHÇV<br><br>Tani MD | 2016-2017 | I zbatuar | Në datën 14.07.2017, MD në rolin e KKK ka organizuar takimin e tretë të nëngrupit tematik për politikat kundër korrupsionit dhe në të kanë marrë pjesë 46 përfaqësues të institucioneve raportuese. Gjatë periudhës së raportimit, MD ka organizuar një takim me pikat e kontaktit të institucioneve qëndrore, me datë 24.11.2017, ku | Gjatë vitit 2018 do të vazhdojë rritja e kapaciteteve të pikave të kontaktit kundër korrupsionit lidhur me masat antikorrupsion dhe monitorimin e tyre | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | është risqaruar angazhimi i tyre në luftën kundër korrupsionit si dhe raportimi i tyre pranë KKK. Në këte takim kanë marrë pjesë 33 pika kontakti. | | |
| **A. 11. 1** | Krijimi i faqeve web të përditësuara | Prefekturat | Dhjetor 2015 | Pjesërisht e zbatuar | **P.Korcë:** për mungesë fondesh nuk është realizuar hapja e faqes Ëeb.<br><br>**P.Kukës:** Është furnizuar në mënyrë periodike faqja web-it të institucionit me materiale dhe është e aksesueshme.<br><br>**P.Dibër:** është hapur faqja zyrtare e prefekturës në fillim të vitit 2016.<br><br>**P.Berat:** eshte hapur www.prefektiiqarkutberat.gov.al<br><br>**P.Durrës:** Masë e zbatuar në Dhjetor 2017<br><br>**P.Fier:** Në vazhdim jemi në proçedurë e sipër për punësimin e një specialisti IT<br><br>**P.Vlore:** Në mungesë të Faqes Zyrtare të institucionit, ka bërë publikimin në stenda pranë ambjentit të Prefekturës.<br><br>**P.Gjirokaster:** Prefektura Gjirokaster: per mungese fondesh nuk eshte realizuar hapja e faqes web.<br><br>**P.Lezhe:** Mase e pazbatuar | **Prefektura Berat:**<br>1.Parashikimi në buxhetin e vitit të ardhshëm të financimit të bërjes aktive dhe përditësimit të faqes web të Institucionit në shumen 120,000 lekë.<br>2. Do ndërtohet faqja e web-it.<br><br>**P.Vlorë:** Është bërë kërkesë tek AKSHI nga institucioni për të patur të aksesueshme faqen web<br><br>**P.Gjirokastër:** do te planifikohet ne buxhetin e vitit 2018<br><br>**P.Lezhe:** Do hapin faqen e webit gjate 2018 | P.Kukës: 12000 (LEKË) |
| **A. 11. 2** | Krijimi i Mekanizmit të Monitorimit dhe Vlerësimit periodik të | Ish-MMSR<br><br>MSHMS | Janar 2015 e në vijim | I zbatuar | Gjatë vitit 2017 janë kryer 392 kontrolle dhe rikontrolle (për zbatim detyrash) pranë njesive vendore | Do të vazhdojë proçesi i inspektimit | pa kosto shtese |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | ofrimit të shërbimeve dhe ndihmës ekonomike në nivel lokal | | | | | | |
| **A. 11. 3** | Publikimi në ambientet publike dhe internet të Prefekturave të buxheteve dhe shpenzimeve të çdo komunë dhe bashkie në qark | Prefektura | Dhjetor 2015 | Pjeserisht e zbatuar | **P.Elbasan:** Në muajin Janar 2017 janë publikuar buxhetet e 7 Bashkive dhe të Këshillit të Qarkut në ambjentet e Prefktures.<br><br>**P.Korçë:** Në ambjentet e Prefekturës publikohen buxhetet e çdo bashkie sipas miratimit të tyre në Këshillat Bashkiake<br><br>**P.Kukës:** Janë bërë të aksesueshme për qytetarët miratimi dhe konfirmimi i buxheteve të bashkive si dhe disa vendime tjera me interes publik si investime,bursa, rialokime fondesh etj; P.Berat: Buxhetet vjetore te Njesive te Qeverisjes Vendore janë të depozituar në ambjentet në hyrje të Institucionit të Prefektit dhe jo në faqen web<br><br>**P.Durrës**: Meqenëse faqja zyrtare ka përfunduar në Dhjetor 2017 buxhetet ende nuk janë publikuar në faqen zyrtare. Ato publikohen në ambjentet e institucionit.<br><br>**P.Fier:** Bashkia Fier, Bashkia Patos, Bashkia Rroskovec bashkë me njesitë vendore në juridiksionin e tyre e kanë përfunduar dhe publikuar.<br><br>**P.Vlorë**: Janë afishuar në stendat në ambientin e Prefekturës të gjitha Vendimet e Këshillave Bashkiake për miratimin, ndryshimin e buxheteve; të ardhurat tatimore, jo tatimore si edhe shpenzimet e bashkive.<br><br>**P.Lezhe:** Janë afishur në ambjentet e institucionit buxheti, struktura. | **Prefektura Berat:**<br>1.Eshte parashikuar në buxhetin e vitit të ardhshëm të financimit të bërjes aktive dhe përditësimit të faqes web te Institucionit në shumën 120,000 lekë.<br>2. Do te krijohet faqja e internetit dhe linku që do të drejtojë kërkuesit në web faqet ku publikohen vendimet e Këshillave të Bashkive<br><br>**P.Fier:** Në vazhdim po punohet edhe në Bashkitë e tjera Lushnjë ,Ballsh<br><br>**P.Vlorë:** Do vazhdojë të bëjë afishimin e çdo vendimi, akti, të buxheteve dhe shpenzimeve në shërbim të transparencës për qytetarët. | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **P.Gjirokastër:** Në ambjentet e Prefekturës ka vetëm pak ditë që është vendosur këndi i ri i Publikimeve në të cilin ka filluar të publikohen vendimet e Këshillat Bashkiake | | |
| **A. 11. 4** | Krijimi i regjistrit tematik të ankesave | Prefektura | Dhjetor 2016 | Pjeserisht e zbatuar | **P.Elbasan:** në peiudhën Janar - Dhjetor 2017 janë regjistruar 171 ankesa. Në portalin StopKorrupsioni janë trajtuar 11 ankesa.<br><br>**P.Korçë:** Është krijuar regjistri elektonik tematik i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve dhe bëhet përditesimi i tij.<br><br>**P.Kukës:** Në bazë të të dhënave të rregjistrit "të librit të ankesave të qytetarëvë" pranë arkivit rezulton se për periudhën Janar-Nëntor 2017 janë trajtuar 112 raste ankesash të ardhura në Institucion.<br><br>**Prefektura Dibër:** Është krijuar regjistri i kërkesë ankesave që në janar 2015. Vazhdon edhe për 2017. Janë trajtuar për per periudhen Janar - Nëntor 2017 janë trajtuar 260 kërkesë ankesa. Nga portali stop koorrupsioni vetëm 2 ankesa. Njera prej tyre ishte premtim elektoral.<br><br>**Prefektura Berat:** Aktualisht veprohet me regjistrimin e ankesave/kërkesave në regjistrin e protokollit të shkresave. Janë regjistruar dhe trajtuar gjithesej125 ankesa të depozituara në protokoll të Istitucionit nga të cilat 3 ankesa nga zyra e bashkëqeverisjes,62 janë për Komisionin Vendor i Vlerësimit të Titujve të Pronësisë.<br>Menjëherë pas krijimit të faqes së internetit do të krijojmë një seksion në faqe ku qytetarët ti drejtohen direkt Prefektit në lidhje me një ankesë/kërkesë. Gjithshtu do të krijojmë online regjistrin e ankesave, i cili do të përditësohet | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | periodikisht nga administrata dhe ku kërkuesi/ankimuesi do të marrë informacion në lidhje me ecurinë e kërkesës së vet dhe ne ca faze trajtimi ndodhet ajo.<br><br>**P.Shkodër** - për periudhen Janar-Dhjetor 2017 janë trajtuar rreth 180 ankesave në rregjistrin e Prefekturës Shkodër me tema të ndryshme. 7- denoncime nga Portali Stop-Korrupsi.al<br><br>**P.Durrës:** Janë regjistruar 151 ankesa në periudhën Janar - Dhjetor 2017.<br><br>**P.Fier:** Është hapur regjistri tematik i ankesave. Janë trajtuar 18 kërkesë- ankesa.<br><br>**P.Vlore:** Është i krijuar regjistri tematik i ankesave dhe në vazhdimësi regjistrohen e ndiqen problematikat e paraqitura nga qytetarët, duke kërkuar të arrihet në zgjidhjen e tyre ose duke e orientuar qytetarin dhe ia kaluar rastin për kompetencë institucionit përgjegjës.Janë 193 kërkesë/ankesa nga KVVTP; 54 kërkesë/ankesa tek SMKVFD; 32 kërkesë/ankesa tek S.Juridik . 93 kërkesë/ankesa janë kaluar për kompetencë institucionit përkatës.<br><br>**P.Lezhe**: është krijuar rregjistri i ankesave për vitin 2017<br><br>**P.Gjirokastër:** Është krijuar regjistri elektronik tematik i ankesave dhe kërkesave të qytetarëve dhe bëhet përditësimi I tij. | | |
| **A. 11. 5** | Ofrimi i shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike | Bashkitë | 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Janë ngritur zyrat me një ndalesë për ofrimin e shërbimeve administrative në nivel vendor përmes sporteleve unike në 12 bashki me mbështetjen e DLDPsë (financuar nga SDC - Qeveria Zvicerane) | Inventarizimi i shërbimeve aktuale dhe identifikimi i shërbimeve parësore për tu ofruar janë pjesë e fazës së | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | në 5 bashki dhe atë të PLGP(USAID) në 6 bashki. Ndërkohë Bashkia e Urës Vajgurore ka ngritur zyrën me një ndalesë nëpërmjet buxhetit të bashkisë. Është tenderuar dhe ka filluar zbatimi i kontratës “Krijimi i sporteleve me një ndalesë për shërbimet administrative në nivel vendor” në 49 bashki me mbështetjen e projektit STAR2. Kontrata për “Krijimin e sporteleve me një ndalesë për shërbimet administrative në nivel vendor” në 49 bashki përfshin: 1. Vlerësimin fillestar të situatës dhe analizën e biznesit; 2. Analizën e softuerit dhe fazën e projektimit; 3. Personalizimin dhe zhvillimin i softuerit; 4. Zbatimin tek bashkitë pilot dhe fazë e stabilizimit; 5. Zbatimi tek bashkitë e mbetura; dhe 6. Fazën e mbylljes. Lidhur me adoptimin e modifikimeve të nevojshme ligjore për ofrimin e shërbimeve në formë elektornike, në vitin 2017 është miratuar VKM, Nr. 673 datë 22.11.2017 “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI). Kjo VKM zgjeron fushën e veprimtarisësë AKSHI-t dhe ngarkon këtë institucion me këto kompetenca:<br>• Ofrimin e shërbime të përqëndruara nëpërmjet teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike, për administratën shtetërore, qytetarët, bizneset;<br>• Përcaktimin e standarteve shqiptare të shërbimeve publike elektronike (e-shërbime);<br>• Ofrimin e shërbimeve të autentifikimit, nënshkrimit elektronik dhe vulës digjitale për organet dhe institucionet e administratës publike dhe subjektet private; | vlerësimit të situatës në bashki dhe analizës së biznesit dhe pritet të përfundojë në Janar të 2018. Ngritja e qëndres për ofrimin e shërbimeve në modelin “one stop shop" në 49 bashkitë e mbetura pritet që të finalizohet në fund të vitit 2019. | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | • Ofrimin e sistemeve IT, infrastrukturë hardëare dhe TIK për ADISA-n, në kuadër të ofrimit të shërbimeve publike në sportele fizike nga ana e saj (ku perfshihet Sistemi i Administrimit të Dokumentit Elektronik, përfshirë protokollin dhe arkivin elektronik; | | |
| **A. 11. 6** | Publikimi në ambientet publike të çdo prefekture të akteve nënligjore te miratuara nga bashkitë përkatëse të qarkut | Prefektura | 2017 | Pjeserisht i zbatuar | **P.Elbasan:** Institucioni i Prefektit publikon në mënyrë të përmbledhur nr. datë dhe titull të vendimit dhe me kërkesë pa pagesë i jepet vendimi i plotë. Vendimet e Keshillave Bashkiake publikohen në faqet zyrtare të tyre.<br><br>**P.Korcë:** Në ambjentet e Prefekturës publikohen vendimet e këshillave bashkiake.<br><br>**P.Kukës:** Është hedhur në faqen e ëeb të Prefekturës Kukës i gjithë dokumentacioni që kërkohet për këtë qëllim në ikonën 'Transparenca e Vendimeve".Do të vazhdojmë të përditësojmë të gjithë materialet që kërkohen në zbatim të kësaj mase e cila konsiderohet e zbatuar.<br><br>**Prefektura Dibër**: Janë puplikuar në ambientet e institucionit buxhetet e bashkive Dibër, Mat, Klos, Bulqizë, Këshilli i Qarkur dhe buxheti i prefekturës të vitit 2017.<br><br>**Prefektura Berat**: Vendimet e miratuara nga Bashkitë dhe Këshilli i Qarkut janë të depozituara në Sektorin Juridik (sigurohen nga të interesuarit me kërkesë dhe pa pagesë).Për këtë periudhë ne total janë 245 akte juridike, nga të cilat 239 të miratuara dhe 6 të pabazuara në ligj. P.Shkodër: Publikimi në faqen ËEB. www.prefektishkoder.gov .al. 5-Bashkitë në faqet zyrtare e kanë detyrim publikimim e VKB. | **P.Elbasan:** Do të vazhdojë dhënia e vendimeve me kërkesë të thjeshtë pa kosto për qytetarët.<br><br>**Prefektura Berat:**<br>1.Parashikimi në buxhetin e vitit të ardhshëm të financimit të bërjes aktive dhe përditësimit të faqes WEB të Institucionit në shumën 120,000 lekë.<br>2. Krijimi i faqes së internetit dhe linku që do të drejtojë kërkuesit në web faqet ku publikohen | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | **P.Durrës:** Vendimet e Këshillave Bashkiakë publikohen në faqet zyrtare të tyre. Ato akoma nuk janë publikuar në faqen zyrtare për shkak se kjo faqe është hapur në Dhjetor 2017.<br><br>**P.Fier:** Janë publikuar pranë Zyrës së informacionit të Prefektit të Qarkut Fier aktet nënligjore të miratuara në muajin Dhjetor në 6 Bashkitë e Qarkut konkretisht :Bashkisë Fier ,Bashkisë Roskovec, Bashkisë Ballsh, Bashkisë Patos,Lushnjë, Divjakë<br><br>**P.Vlorë:** Aktet nënligjore të miratuara nga bashkitë janë publikuar në ambientin e Prefekturës.Publikimi bëhet me të gjithë elementë e shkresës (aktit). Personat e interesuar që paraqesin kërkesën e kanë marrë shërbimin pa pagesë.<br><br>**P.Gjirokastër:** Në ambjentet e Prefekturës publikohen vendimet e këshillave bashkiake.<br><br>**P.Lezhë:** Janë afishuar në ambjentet e institucionit | vendimet e Këshillave të Bashkive<br><br>**P.Vlorë:** Do vazhdojë të bëjmë afishimin e akteve nënligjore, të miratuara nga bashkitë përkatëse të Qarkut, në shërbim të transparencës për qytetarët.<br><br>**P.Lezhe:** gjate 2018 **d**o realizojme hapjen e faqes zyrtare të institucionit | |
| **B. 1.1** | Realizimi i trajnimeve të përbashkëta të specializuara për hetimin e korrupsionit, veçanërisht në sistemin e drejtësisë dhe të niveleve të larta | PP | 2015-2016-2017 | I zbatuar | Jane realizuar trajnime te përbashkëta me prokurorinë, të organizuar nga Akademia e Sigurisë Tiranë, por edhe institucione të tjera ligjzbatuese apo edhe të organizuara nga partneret apo organizatat ndërkombëtare. | Zhvillimi i trajnimeve të mëtejshme në bashkëpunim me prokurorinë, agjencitë e tjera ligjzbatuese dhe partneret ndërkombëtar për luftën kundër korrupsionit | |
| **B. 1.2** | Rritja e numrit të operacioneve me përdorimin e teknikave speciale të hetimit me 5% çdo vit; Rritja e numrit të hetimeve | PSH | 2015-2016-2017 | Pjesërisht i zbatuar | Për periudhën Korrik-Nëntor 2017 janë referuar 456 vepra penale për korrupsion dhe krime në detyrë, ku në 145 raste po kryhen hetime proaktive për korrupsion dhe krime në detyrë dhe janë realizuar 21 operacione policore. Krahasuar me të njejtën periudhë të vitit 2016 janë referuar 57 | Rritja e numrit të operacioneve policore për korrupsion dhe krime në detyrë | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | proaktive për korrupsion me 5% cdo vit. | | | | vepra penale më shumë, po kryhen hetime proaktive për 30 raste më shumë, si dhe janë realizuar 6 operacione policore me pak. | | |
| **B. 1.3** | Vlerësim i nevojave për pajisje teknike për hetimin e korrupsionit | PP | 2015 | I pazbatuar | Sugjerohet rishikimi i masës duke qënë se në kuadër të zbatimit të reformës në drejtësi, Kushtetuta, Kodi i Proçedurës Penale dhe ligji 95/2016 përcaktojnë se organ kompetent për hetimin e veprave penale të korrupsionit ështe Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit. Gjithsesi ne vlerësojmë se analiza e nevojave me ndihmën e ekspertëve të vendeve te tjera me eskperincë të sukseshme në këtë fushë, duhet të kryhet për ti shërbyer funksionimit sa më të shpejtë të këtyre strukturave pas krijimit të tyre. | | |
| **B. 1.4** | Rritja e numrit të përgjithshem të prokurorëve dhe rritja e nr. të prokuroreve që hetojnë çështjet e korrupsionit, sidomos të nivelit të lartë | PP | 2016-2017 | Pjesërisht i zbatuar | Gjatë vitit 2017 nuk ka patur rritje të numrit të prokurorëve. Për të përballuar volumin e punës në Prokurorinë për Krime të rënda u komanduan edhe 2 prokurorë gjatë kësaj periudhe | | |
| **B. 1.5** | Analizimi i masave të marra nga subjektet e ligjit në kuadër të respektimit të rregullave për masat e vigjilencës së zgjeruar për PEP, OJF dhe grupe të tjera klientësh të kategorizuara me risk të lartë për pastrimin e parave dhe financimin e terrorizmit. | DPPPP | Çdo vit | I zbatuar | Gjatë periudhës Janar-Nëntor 2017 janë kryer 56 inspektime në vend dhe 103 në distancë. | | Nuk ka kosto shtesë |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **B. 1.6** | Module trajnimesh përfshijnë çështje që lidhen me ndëshkimin e korrupsionit | PP | 2017 | I zbatuar | Janë zhvilluar trajnimet si vijon:<br><br>1. 13-14 nëntor 2017, "Integriteti i zyrtarëve të agjencive ligjzbatuese dhe lufta kundër korrupsionit. Korrupsioni i funksionarëve të lartë të drejtësisë dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë. • Korrupsioni si një çështje etike e si një vepër penale. • Kuadri ligjor dhe standardet ndërkombëtare; • Problemet e praktikës gjyqësore, në lidhje me hetimin dhe gjykimin e këtyre veprave penale; • Standardet e kërkuara në marrëdhëniet profesionale midis gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe gjyqtarëve/prokurorëve dhe avokatëve." nr. i pjesëmarrësve: 13 prokurorë;<br><br>2. 20 nëntor 2017, "Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale. • Konventat ndërkombëtare lidhur me pastrimin e produkteve të veprës penale. Vështrim i shkurtër mbi Konventën e Varshavës, Palermos e Vjenës; • Legjislacioni procedural penal mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive; • Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe risitë e tij; • Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përfshirë në veprat penale përkatëse; • Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e veprës penale të pastrimit të parave; • Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit nëpërmjet shenjëstrimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal." nr. i pjesëmarrësve: 33 prokurorë. | | |
| **B. 1.7** | Garantimi i qëndrueshmërisë së Oficerëve të Policisë Gjyqësore (OPGJ) të atashuar pranë njësive të përbashkëta të hetimit dhe rregullimi (edhe ligjor nëse nevojitet) i problematikavë që lidhen me statusin e tyre | PP | 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Ligji "Për Policinë Gjyqësore"është në proçes rishikimi në kuadër të Reformës në Drejtësi. | | |
| **B. 1.8** | Krijimi i shërbimeve të ekspertimit pranë sistemit të prokurorisë | PP | 2015-2016 | I zbatuar | Aktualisht (dhjetor 2017) në Prokurorinë e Përgjithshme ushtrojnë funksionin 6 ekspertë: 3 ekspertë kontabël, 1 ekspert auto-teknik. 2 ekspert informatike. | | |
| **B. 2.1** | Akses i limituar deri në ndërlidhjen e plotë i Prokurorisë në disa databaza shtetërore | PP | | Pjesërisht i zbatuar | Në korrik 2017 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për “Shkëmbimin e Informacionit Ndërmjet Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes së Policisë së Shtetit dhe Sistemit të Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë”, ndërsa në Gusht 2017 është rënë dakort në parim me Zyrën Qendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit “Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme” dhe po proçedohet më tej me reflektimin e teknikaliteteve. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **B. 2.2** | Vlerësimi i aksesit në të gjitha databazat shtetërore dhe analizë teknike e standardeve ndërkombëtare lidhur me aksesin e institucioneve ligjzbatuese në databaza | MD | 2016 | Pjesërisht i zbatuar | Nuk ka ndryshime nga raportimi i kaluar. Sugjerohet rishikimi i masës pasi KKK i ka vendosur në dispozicion PP dhe PSH listën e plotë të regjistrave kombëtar të regjistruar pranë AKSHI.<br>Në bazë të kësaj liste por edhe nevojave te institucioneve, secila ka hartuar listen e databazave ku kërkon akses për periudhën në vijim.<br><br>Megjithatë, KKK nuk ka disponuar raporte vleresimi të mirëfillta apo dokumenta të termave të referencës për zbatimin e aksesit. | | |
| **B. 2.3** | Mundësimi i aksesit elektronik permanent të organeve ligjzbatuese në databaza shtetërore në bazë të vlerësimeve dhe kërkesave | MD | 2017 | Pjesërisht i zbatuar | Për këtë periudhë raportimi nuk ka asnjë përditësim lidhur me aksesin e ketyre institucioneve ne databasa | | |
| **B. 2.4** | Analizimi i rasteve të cilat kanë tregues të dyshimtë për raste korruptive apo pasuri të pa justifikuara | DPPPP | 2015-2017 | I zbatuar | Gjatë periudhës Janar-Nëntor 2017 DPPPP ka bërë 357 referime në organet kompetente (DPPSH dhe PP). | | Nuk ka kosto shtesë |
| **B. 2.5** | Krijimi i aksesit të përhershëm të prokurorisë tek baza e te dhënave të regjistrave publikë me qëllim rritjen e efektivitetit në kryerjen e hetimeve | PP | 2016 | Pjesërisht i zbatuar | Në korrik 2017 është nënshkruar marrëveshja e bashkëpunimit për “Shkëmbimin e Informacionit Ndërmjet Sistemit të Menaxhimit Policor të Çështjes së Policisë së Shtetit dhe Sistemit të Menaxhimit të Çështjes së Prokurorisë”, ndërsa në Gusht 2017 është rënë dakort në parim me Zyrën Qendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit “Për dhënien e të drejtës së aksesit prokurorisë në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme” dhe po proçedohet më tej | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | me reflektimin e teknikaliteteve. | | |
| **B. 2.6** | Standardizimi i Manualeve të Punës për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni për strukturat hetimore dhe informuese | DPD | Maj 2015 | I zbatuar | 1. Janë miratuar manualet e punës për të gjitha strukturat e DPD. 2. Rastet e zbuluara publikohen periodikisht në faqen zyrtare të Doganës | Vijimi i zbatimit të ketyre masave | Pa kosto shtesë |
| **B. 2.7** | Shtrirja e mëtejshme e aksesit të DPPPP në baza të dhënash të institucioneve publike | DPPPP | Qershor 2015 | I pazbatuar | Nuk ka arritje as progres dhe kjo nuk varet nga DPPPP | Meqënëse një pjesë e bazave të dhënave shteterore është në proçes kalimit administrimi nga AKSHI, gjatë 2018 do të vendosen kontakte me AKSHI për zgjidhjen e kësaj problematike dhe aksese të tjera të nevojshme. Në lidhje me çështjen e TIMS, kjo do të jetë pjesë e diskutimeve me Policinë në kuadër të rishikimit të Memorandumeve të Bashkëpunimit midis institucioneve gjatë 2018 | Nuk ka kosto shtesë |
| **B. 2.8** | Trajnime të përbashkëta Polici-Gjyqësor lidhur me ndëshkimin e veprave të korrupsionit dhe ndryshimet ligjore | SHM | 2015-2017 | Pjesërisht i zbatuar | Në muajin nëntor 2017 janë realizuar 2 aktivitete trajnuese, konkretisht: 1. 13-14 nëntor 2017, "Integriteti i zyrtarëve të agjencive ligjzbatuese dhe lufta kundër korrupsionit. Korrupsioni i funksionarëve të lartë të drejtësisë dhe zyrtarëve të tjerë të lartë shtetërorë. • Korrupsioni si një çështje etike v si një vepër penale. • Kuadri ligjor dhe standardet ndërkombëtare; • Problemet e praktikës gjyqësore, në lidhje me hetimin dhe gjykimin e këtyre veprave penale; • Standardet e kërkuara në marrëdhëniet profesionale midis gjyqtarëve dhe prokurorëve si dhe | Shkolla e Magjistraturës do të realizoj 3 trajnime të rëja më tëmatikë korrupsionin, dhe ne dy prej tyre do të ftoj për të qënë pjesëmarrës edhe oficëre policie. Konkretisht, bëhet fjalë për trajnimin me teme: "Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale. • Konventat ndërkombëtare | Këto trajnime janë bërë me fondet e ISLP, PAMECA, ndërsa nga buxheti i shtetit janë harxhuar vetëm 64000 lekë si zë qera salle |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | gjyqtarëve/prokurorëve dhe avokatëve." nr. i pjesëmarrësve: 13 prokurorë, 20 gjyqtarë; 2. 20 nëntor 2017, "Parandalimi dhe goditja e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe veprave të tjera penale.<br>• Konventat ndërkombëtare lidhur me pastrimin e produkteve të veprës penale. Vështrim i shkurtër mbi Konventën e Varshavës, Palermos e Vjenës;<br>• Legjislacioni procedural penal mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive;<br>• Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe risitë e tij; • Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përfshirë në veprat penale përkatëse; • Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e veprës penale të pastrimit të parave; • Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit nëpërmjet shenjëstrimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal." nr. i pjesëmarrësve: 33 prokurorë, 5 gjyqtarë. | lidhur me pastrimin e produkteve të veprës penale. Vështrim i shkurtër mbi Konventën e Varshavës, Palermos e Vjenës; • Legjislacioni procedural penal mbi sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive; • Zbatimi i ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009, "Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë" dhe risitë e tij; • Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përfshirë në veprat penale përkatëse; • Kompetencat e gjykatës për shqyrtimin e veprës penale të pastrimit të parave; • Dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit nëpërmjet shenjëstrimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal.", i cili do të zhvillohet në muajin janar 2018, dhe trajnimi me temë: "Veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit. • Hetimet paralele | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | financiare kriminale për identifikimin dhe ngrirjen e produkteve ose pasurisë që rrjedh nga kjo veprimtari; • Efektet në drejtim të parandalimit të pastrimit të parave nëpërmjet dënimit të autorëve të këtyre veprave dhe konfiskimit të pasurive që rrjedhin nga veprimtaria kriminale.", i cili do te zhvillohet ne muajin maj 2018. | |
| **B. 2.9** | Ngritja e mekanizmave të bashkëpunimit midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe zyrës së Prokurorit për Krimet e Rënda | Byroja Kombëtare e Hetimit (BKH) | 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Nuk ka përditësime për këtë fazë raportimi. Nuk është krijuar akoma dhe është institucion I pavarur tashmë. | | |
| **B. 2.10** | Memorandum bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme për shkëmbimin e informacionit mbi ankesat për korrupsion, duke përfshirë edhe shkëmbimin e informacionit për gjyqtarët në ndjekje penale | KLD | Dhjetor 2015 | Pjesërisht i zbatuar | Masa mbetet të zbatohet konkretisht me krijimin e Këshillit të Lartë të Gjyqësorit dhe të administratës përkatëse. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **B. 3.1** | Rishikimi i memorandumeve dhe për NJPH-te për shkak të nevojës së: -përfshirjes së veprave të reja dhe ndryshimit të kompetencës për disa prej tyre -nevojës për një harmonizim të ri të bashkëpunimit ndërinstitucional. | PP | 2015 | I zbatuar | Kjo masë teorikisht është e realizuar, duke qënë se kuadri ligjor ndryshoi terësisht. Kushtetuta, Kodi i Proçedures Penale dhe ligji 95/2016 përcaktojnë si organ kompetent për hetimin e veprave penale të korrupsionit është Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit. | | |
| **B. 3.2** | Rishikimi i kuadrit ligjor lidhur me çështjet e përgjimeve dhe komunikimeve elektronike | Ish-MIAP | 2015-2017 | I zbatuar | Miratuar ligji Ligji nr. 69/2017 datë 27.4.2017 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9157, datë 4.12.2003, "Për përgjimin e komunikimeve elektronike", të ndryshuar | | |
| **B. 3.3** | Miratimi i ndryshimeve ligjore për zgjatjen e afatit të hetimeve paraprake deri në 6 muaj | MD | 2017 | I zbatuar | Me ligjin nr. 35/2017 janë miratuar rregullat e reja në Kodin e Proçedurave Penale, të cilat kanë hyrë në fuqi me datë 1 gusht 2017. | Zbatimi i këtyre rregullave nga organet ligjzbatuese | |
| **B. 3.4** | Ndryshime në KPP lidhur me imunitetet | MD | 2015 | I zbatuar | Me ligjin nr. 88/2012 "Për disa ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar" u ndryshua neni 73 i Kushtetutës në lidhje me imunitetin e deputetit. Në rast se deri në vitin 2012, organi proçedues as nuk mund të niste dhe nuk mund të kryente asnjë veprim proçedural ndaj një personi që gëzonte imunitet kushtetues, i dyshuar për kryerjen e një vepre penale, me ndryshimet në fjalë, ky imunitet u kufizua vetëm në rastet kur kërkohej arrestimi, heqja e lirisë (ndalimi) apo kontrolli personal apo i banesës. Sipas nenit 73 pika 2 të Kushtetutës: "Deputeti nuk mund të arrestohet | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | ose t'i hiqet liria në çfarëdo lloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës, pa autorizimin e Kuvendit".<br>Me ligjin nr. 35/2017 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7905, datë 21.3.1995, "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar", neni 288 dhe neni 289 i këtij Kodi janë ndryshuar. Bazuar në nenin 288 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori në rastet kur ndaj një deputeti duhet të caktojë masën e sigurimit të arrestit në burg ose në shtëpi, heqje të lirisë në çfarëdo lloj forme, kontrollin personal ose të banesës, duhet t'i kërkojë Kuvendit autorizim. Kërkesa e prokurorit duket të ketë një relacion të arsyetuar, të shoqëruar me provat që mbështesin kërkesën e tij. Pra, ndryshimet e bëra këtij neni me ligjin 35/2017, kërkojnë që prokurori të sjellë bashkë me kërkesën, jo vetëm relacionin se ku e mbështet kërkesën por edhe prova mbi bazën e të cilës prokurori ka vendosur të caktojë ndaj deputetit masën e sigurimit arrest në burg ose në shtëpi, heqje të lirisë apo çfarëdo lloj forme, kontrolli personal apo të banesës. Në rastet e arrestit në flagrancë të deputetit, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme ka detyrimin të njoftojë Kuvendin. Kur Kuvendi vendos heqjen e masës së arrestit në flagrancë, deputeti lirohet menjëherë.<br>Ndryshimi i nenit 289 i jep mundësi prokurorit të caktojë një masë tjetër sigurimi, sipas parashikimeve të nenin 244 të Kodit të Procedurës Penale dhe të procedojë ndaj tij dhe personave të tjerë për të cilët zhvillohen hetime për të njëjtin fakt. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Këto ndryshime i japin mundësi prokurorit në rastet kur nevojat e sigurimit rëndohen apo kur nga hetimet rezultojnë fakte ose rrethana të reja, të mund t'i drejtohet Kuvendit (i cili mund të jetë shprehur më parë për mosdhënien e autorizimit) për të kërkuar autorizim, sipas paragrafit 1, të nenit 288, të këtij Kodi. Edhe në rastet e heqjes së masës së arrestit në flagrancë, sipas paragrafit 3, të nenit 288, të këtij Kodi, nuk e pengon prokurorin t'i kërkojë Kuvendit autorizim, sipas paragrafit 1 të nenit 288. | | |
| **B. 3.5** | Forcimi i ekipeve të përbashkëta hetimore | PP | 2015-2017 | I zbatuar | I njëjti arsyetim si për masën B.3.1 | | |
| **B. 4.1** | Ngritja e ekipeve të përbashkëta hetimore për hetimin e krimit ndërkombëtar | PP | 2015 | I pazbatuar | Nuk janë ngritur ekipe hetimore për çështje korrupsioni | | |
| **B. 4.2** | Trajnimi i përbashkët mbi bashkëpunimin me kundërpalët e huaja | PP | 2016 | Pjesërisht i zbatuar | Në datat 12-14 shtator 2017, 2 prokurorë kanë marrë pjesë në konferencën me temë "Lufta kundër krimit të organizuar, korrupsionit dhe terrorizmit" organizuar në Malin e Zi. | | |
| **B. 4.3** | Forcimi i lidhjeve dhe bashkëpunimit me autoritetet simotra në vendet e tjera | PP | 2016 | Pjesërisht i zbatuar | Në muajin Tetor 2017 është nënshkruar në Tiranë një Protokoll i cili përcakton modelin e marrëveshjes për krijimin e një ekipi të përbashkët hetimi Mes Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë Dhe Drejtorisë së Cështjeve Kriminale dhe të Faljeve, pranë Ministrisë së Drejtësisë të Republikës së Francës.<br><br>Në muajin Nëntor 2017 është nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi Ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Gjykatës Supreme të Apelit të Republikës së Turqisë dhe | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë. | | |
| **C. 1.1** | Përgatitja e draftit të kurikulës | Ish-MAS | Shtator 2015 | I raportuar | | | |
| **C. 1.2** | Pilotimi i Kurrikulës në disa shkolla të mesme | Ish-MAS | Tetor 2015 | I zbatuar | I zbatuar në 2015. | | |
| **C. 1.3** | Takime në shkollat e mesme mbi vlerësimin dhe përmirësimin e kurrikulave | Ish-MAS | Mars 2016 | I pa raportuar | | | |
| **C. 1.4** | Promovimi i etikës profesionale nga punonjësit mësimorë | Ish-MAS | 2015-2017 | I pa raportuar | | | |
| **C. 1.5** | Organizimi i Konferencës Kombëtare për Luftën kundër Korrupsionit | MD | 2015 | I zbatuar | Masë e realizuar prej vitit 2016. | | |
| **C. 1.6** | QKEV do të njohë kreditet e trajnimeve me temë antikorrupsion me 5 -10 kreditë | Ministria e Shëndetësisë (MSH) | Tetor 2015 | I zbatuar | Për këtë perjudhë nuk është akredituar asnjë aktivitet për luftën kundër korrupsionit në shëndetësi | Nëse do të ketë kërkesa do të akreditohen aktivitete për luftën kundër korrupsionit në shëndetësi | pa kosto shtesë per institucionet, paga e punonjesve gjatë orarit zyrtar |
| **C. 1.7** | Krijimi i një Fondi Specifik për mbështetjen e aktiviteteve që lidhen me anti-korrupsionin, monitorimin dhe/ose transparencën | Agjensinë Shqiptare për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) | 2015-2016 | I zbatuar | Agjencia për Mbështejen e shoqerise Civile ka akorduar nje fond total prej 15,400,000 lekësh për financimin e projeketeve me tematike dhe për qëllim luftën ndaj korrupsionit, çështje të monitorimit dhe të transparencës dhe keto projekte janë në ndjekje ose dhe kanë përfunduar sipas termave të kontratës të lidhur mes OJF dhe AMSHC-se. | Vijon puna për ndjekjen e projekteve të financuara me tematikën antikorrupsion/monitorim/transparence. | 15,400,000 ALL |
| **C. 1.8** | Fushata ndërgjegjësuese parazgjedhore për dekurajimin e diktimit të votës në mënyra të ndryshme | KQZ | Qershor 2015, Qershor 2017 | I zbatuar | Për zgjedhjet parlamentare 2017 u realizua fushata edukuese dhe informuese për zgjedhësit, në zbatim të strategjsë së edukimit zgjedhor të miratuar nga Komisioni. Përmes 6 spoteve televizive të transmetuara 816 herë në | Programe edukimi për ndërgjegjësimin e zgjedhësve për fenomonenin "blerja e votës" | |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 11 TV me shtrirje sinjali në të gjithë territorin dhe gjithashtu 24 h në faqen e 3 ëebsiteve më të klikuara,2 spoteve radiofonike të transmetuara 592 herë në 3 radio me shtrirje sinjali në të gjithë vendin, 8 modele posterash që u publikuan 126 herë në 9 gazeta me format të printuar, u dha informacion i plotë për veprat penale në zggjedhje dhe masën e dënimit për to, sipas ndryshimeve të Kodit Penal të majit 2017. Projekt i veçantë u realizua për ndërgjegjësimin e komunitetit rom për fenomenin negativ të shitblerjes së votës. Sesione edukimi u zhvilluan në të gjitha vendqëndrimet e komunitetit në 11 qarqe te vendit.<br>Për ndërgjegjësimin e votuesve për herë të parë në të 385 shkolla e mesme në të gjithë vendin, ku morrën pjesë 35 000 maturantë, votues për herë të parë. Për herë të parë në zgjedhjet e 25 qershorit, KQZ realizoi aplikacionin “VOTO 2017” për pajisjet android dhe IOS, i cili mundësoi informimin dhe komunikimin interaktiv kryesisht me votuesit e rinj që janë edhe përdoruesit më të shumtë të teknologjisë së informacionit. Ky aplikacion, mundësonte gjithashtu raportimin në kohë reale përmes fotografive apo videove për mashtrime elektorale, intimidimin e votuesve apo praktika të tjera të kundraligjshme. Për votuesit që nuk do të kishin të mundur përdorimin e aplikacionit, KQZ vuri në dispozicion numrin e telefonit pa pagesë. Adresa e aplikacionit, numri telefonik pa pagesë u publikua në të gjithë spote, posterat dhe fletëpalosjet, ku përmes | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | mesazheve sensibilizuese u synua ndërgjegjësimi I votuesve për të denoncuar çdo veprim korruptiv që cënonte votën e lirë dhe demokratike. | | |
| **C. 1.9** | Realizimi i fushatave ndërgjegjësuese për shmangien e korrupsionit në Sistemin e Burgjeve | Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve | 2015-2017 | I zbatuar | Në mbështetje të prioriteteve të punës së Ministrisë së Drejtësisë u zhvillua në sistemin e burgjeve fushata antikorrupsion. E konceptuar si një seri aktivitetesh përgjatë 4 muajve, fushata filloi në një nga IEVP më të mëdha në vend, në Peqin. 10 IEVP të cilat u përzgjodhën për të qenë pjesë e kësaj fushate, nisur nga kapaciteti i institucioneve dhe performanca përfshijnë: IEVP Peqin, Lushnjë, Vaqarr, Durrës, Korçë, Rrogozhinë, Jordan Misja, Mine Peza, Ali Demi dhe Lezhë. Në këto IEVP u zhvilluan seanca informuese dhe sensibilizuese me të burgosurit gjatë një periudhe 4-mujore. Gjatë këtyre seancave, të cilat u drejtuan nga stafi social i IEVP, u prezantuan për të burgosurit materiale dhe informacione në lidhje me korrupsionin në përgjithësi si fenomen dhe format me të cilat shfaqet, studimet e kryera në lidhje me korrupsionin në Shqipëri dhe jashtë saj, luftën kundër korrupsionit dhe masat legjislative në funksion të rritjes së respektimit të drejtave të personave me liri të kufizuar etj. Krahas këtyre materialeve, u shpjeguan edhe materialet bazë mbi të cilat vendoset puna konkrete e IEVP. | Përcaktimi i indikatorëve të përfomancës për çdo IEVP dhe ndërmarrja e fushatave te tjera sensibilizuese në IEVP | Kosto administrative |
| **C. 2.1** | Publikimi online i të gjitha akteve nënligjore që parashikojnë procedurat e trajtimit të ankesave dhe afatet | Të gjitha institucionet | Mars 2015 | Pjesërisht e zbatuar | Institucionet kanë raportuar se vazhdon publikimi. | Vazhdon publikimi. | Pa kosto shtese |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **C. 2.2** | Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me ligjin për të drejtën e informimit | KDIMDP | Janar 2015- Dhjetor 2016 | Pjesërisht i zbatuar | Përditësimi i faqes së internetit dhe portalin "Pyetshtetin.al "<br><br>Do të vijojë lidhur me hartimin dhe promovimin e materialeve ndërgjegjësuese. | Do të vijojë lidhur me hartimin dhe promovimin e materialeve ndërgjegjësuese | Pa kosto |
| **C. 2.3** | Konceptimi i një fushate kombëtare për ndërgjegjësimin e publikut në luften kundër korrupsionit dhe zbatimi i fushatës | MSHÇV | Qershor 2016 | I zbatuar | Fushata kombëtare e ndërgjegjësimit u konceptua dhe lancua me sloganin "KorrupsJOn". Faza e dytë e fushatës u fokusua ne mediat online (Njoftime ne mediat sociale, Google Ads, Web Banner dhe Materiale promocionale) e cila filloi me 09.12.2016 dhe zgjati 45 ditë. | Do vijoj me fushata ndërgjegjesimi | |
| **C. 2.4** | Zbatimi i projektit "Citizen Feedback SMS plug" | MSHÇV | Dhjetor 2016 | I zbatuar | | | |
| **C. 2.5** | Ndërgjegjësimi i publikut në lidhje me ligjin 146/2014 "Për njoftimin dhe Konsultimin publik" | MIAP | 2016 | I zbatuar | | | |
| **C. 3.1** | Rishikimi i kuadrit ligjor mbi bashkëpunimin e publikut për denoncimin e rasteve kundër korrupsionit. | MSHÇV | 2015 | I zbatuar | I zbatuar që në 2015 | | |
| **C. 3.2** | Përfshirja e shoqatave të pacientëve në hartimin e akteve që kanë të bëjnë me shëndetin publik | Ish-Ministria e Shëndetësisë (MSH)<br><br>MSHMS | Duke filluar nga Shtator 2014 e në vijimësi | I zbatuar | Zhvillimi i takimeve për konsultim dhe marje mendimi me shoqata të pacienteve. | | Pa kosto shtesë |
| **C. 3.3** | Fuqizimi i bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me median nëpërmjet: 1. Vizitave studimore të | Avokati i Popullit (AP) | 2015-2017 | I zbatuar | Do vijojë bashkëpunimi. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | gazetarëve; 2. Takime periodike mujore me rrjetin e gazetarëve | | | | | | |
| **C. 3.4** | Miratimi i Urdhrit të KM për ngritjen e grupit konsultativ për politikat kundër korrupsionit | KM | Mars 2015 | I zbatuar | Konsiderohet e zbatuar në kuader të themelimit të Grupeve të Integruara të Menaxhimit të Politikave dhe Nën-Grupit tematik për Politikat Kundër Korrupsionit. | Rekomandohet rishikimi i kësaj Mase. | |
| **C. 3.5** | Publikimi i Raportit Vjetor të Monitorimit për Zbatimin e PV për vitin 2014 | MSHCV | Dhjetor 2015 | I zbatuar | I zbatuar<br>Raporti i Monitorimit vjetor 2015 të zbatimit të Planit te Veprimit eshte miratuar në mbledhjen e Grupit Tematik për Politikat Kundër Korrupsionit në Korrik 2016 dhe është publikuar në faqen zyrtare në internet në gjuhën shqipe dhe angleze e është lehtësisht i aksesueshëm nga publiku. Gjithashtu, ka përfunduar edhe raporti i monitorimit të PV për 6-mujorin e parë 2016. | | |
| **C. 3.6** | Organizimi i “Peer Revieë” për zbatimin e kapitujve III dhe IV të Konventës me përfshirjen e shoqërisë civile | MSHCV | Mars 2015 | I zbatuar | I zbatuar<br>Masë e përfunduar por kërkon rishikim sipas kapitujve të rinj pjesë e ciklit të tanishëm të rishikimit të Kapitujve II dhe V të UNCAC | | |
| **C. 3.7** | Realizimi i vlerësimit dhe përputhshmërisë të kuadrit ligjor ekzistues dhe kapitujve të UNCAC | MSHVC | Shtator 2015 | I zbatuar | Masë e përfunduar por kërkon rishikim sipas kapitujve të rinj pjesë e ciklit të tanishëm të rishikimit te Kapitujve II dhe V të UNCAC | | |
| **C. 3.8** | Hartimi i raportit përfundimtar me gjetjet e vlerësimit. | MSHCV | 2015 | I zbatuar | | | |

# VII. REKOMANDIME DHE KONKLUZIONE

## Rekomandime

- Të vazhdojë zbatimi i ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik;
- Të vazhdojë zbatimi i detyrimeve të ligjit për të drejtën e informimit nëpërmjet publikimit të programeve të transparencës si dhe publikimit të informacioneve në zbatim të tij si publikimin e buxhetit, të projekteve, të koncesioneve, të kuadrit ligjor dhe nënligjor etj;
- Të vazhdojë zbatimi i politikës së të dhënave të hapura si për organet e pushtetit qendror dhe ato vendor;
- Të rriten e-sherbimet dhe numri i shërbimeve të ofruara në qendrat me sportel unik;
- Të fuqizohen kapacitet e të gjitha institucioneve në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet trajnimeve të ofruara nga ASPA, Shkolla e Magjistraturës, ILDKPKI etj;
- Të fuqizohen kapacitetet Inspektoriatit Qendror për kryerjen e inspektimeve;
- Të mundësohet publikimi i deklaratave të interesave private pa kërkesë apo në mënyrë automatike, veçanërisht për zyrtarët e lartë dhe për ata të zgjedhur.
- Të rritet aksesi i përhershëm i prokurorisë tek baza e te dhënave të regjistrave publikë me qëllim rritjen e efektivitetit në kryerjen e hetimeve.
- Të realizohet ngritja e mekanizmave të bashkëpunimit midis Byrosë Kombëtare të Hetimit dhe zyrës së Prokurorit për Krimet e Rënda pas krijimit të SPAK;
- Të nënshkruhet Memorandum bashkëpunimi me Prokurorinë e Përgjithshme për shkëmbimin e informacionit mbi ankesat për korrupsion, duke përfshirë edhe shkëmbimin e informacionit për gjyqtarët në ndjekje penale;
- Të ngrihen ekipe të përbashkëta hetimore për hetimin e krimit ndërkombëtar;
- Të vazhdojë trajnimi i përbashkët i prokuroreve mbi bashkëpunimin me homologët në vendet e rajonit dhe më gjerë;
- Të vazhdojë kryerja e aktiviteteve ndërgjegjësuese referuar luftës kundër korrupsionit nga të gjitha institucionet.

## Konkluzione

Lufta kundër korrupsionit është një proçes i vazhdueshëm ndërsektorial, ku vetë përcaktimi dhe matja e treguesve përfundimtar të suksesit është kompleks, sidomos në një kuadër ligjor

dhe institucional në reformim të vazhdueshëm, sikurse është ai që karakterizon Shqipërinë. Duhet nënvizuar fakti se, Reforma në Drejtësi në proçes, Reforma Zgjedhore, por edhe Reforma Administrativo-Territoriale e aprovuar në vitin 2015, kanë ndikuar dhe do të ndikojnë duke ngadalësuar në periudhën afat-shkurtër veprimtarinë e institucioneve përkatëse, duke prekur kështu edhe performancën e zbatimit të objektivave strategjike të kësaj Strategjie.

Gjatë kryerjes së proçesit të monitorimit janë evidentuar disa problematika që vlerësohen se kanë ndikuar në nivelin e zbatueshmërisë së Planit të Veprimit.

Gjatë vitit 2017, zbatimi por edhe monitorimi, si dy proçese të ndërlidhura që kanë orientuar zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Korrupsionit drejt reflektimit dhe konkluzioneve, ku ndër më kryesoret mund të përmenden:

- Ky raport evidenton nevojën urgjente për hartimin e Planit të Ri të Veprimit. Procesi ka nisur dhe pritet të adresojë kërkesat e institucioneve për rishikimin e Masave. Ky proces pritet të adresojë dhe rishprëndarjen e përgjegjësive institucionale në zbatim të VKM-ve për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë 2017.
- Hendeku financiar i Strategjisë mbetet ende problematik dhe prek direkt zbatueshmerinë e planit. Nevojitet prioritizimi i masave dhe mobilizimi i mekanizmave institucionalë për adresimin e hendekut financiar dhe gjetjes së burimeve financiare. Gjithashtu ndërlidhja me PBA dhe parashikimi i mbulimit financiar nga Buxheti i Shtetit duhet të përmirësohet. Plani i ri i Veprimit duhet ti adresojë këto mangësi, duke adresuar kështu dhe raportimin financiar.
- Problematikë mbetet përgjegjshmëria e insitucioneve për raportimin në kohë të informacionit mbi aktivitetet e planifikuara si dhe informacionin mbi disbursimin financiar nga pikat e kontaktit.
- Aty ku është e mundshme, për masat me përgjegjësi shumë-institucionesh, rekomandohet përcaktimi i një institucioni përgjegjës për monitorimin dhe raportimin periodik. Kjo do të optimizonte dhe lehtësonte monitorimin e Strategjisë nga ana e KKK;
- Vihet re gjithashtu një ndërgjegjësim i ulët i përgjithshëm në lidhje me treguesit e zbatimit dhe përcjelljen e informacionit verifikues mbi plotësimin e këtyre treguesve.

## VIII. SFIDAT

Me qëllim përmirësimin e zbatimit dhe rritjes së impaktit të Planit të Veprimit, sfidat e rëndësishme për periudhat vijuese të monitorimit janë:

1. Rritja e nivelit të përgjegjshmërisë dhe llogaridhënies nga strukturat e brendshme të institucioneve përgjegjëse edhe nëpërmjet fuqizimit të koordinimit ndërinstitucional.
2. Kryerja e proçesit të monitorimit periodik, diskutimit të gjetjeve dhe miratimit të raporteve respektive sipas afateve të raportimit të parashikuara në Strategji.
3. Rakordimi i informacionit të marrë nga pikat e kontaktit tek Drejtoritë e Financës, përpara momentit të raportimit pranë KKK.
4. Ndërlidhja me procesin e planifikimit buxhetar vjetor dhe afatmesëm në mënyrë që të sigurohet mbulimi i nevojshëm financiar nga Buxheti i Shtetit për ato masa që parashikohen të zbatohen nëpërmjet Buxhetit të Shtetit.

5. Sigurimi i një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent konsultimi gjatë fazave të raportimit, monitorimit dhe rishikimit të Planit të Veprimit me institucionet përgjegjëse dhe grupet e interesit.
6. Informimi periodik dhe rritja e ndërgjegjësimit të institucioneve përgjegjëse të përfshira në PV mbi rëndësinë që paraqet puna e vazhdueshme për zbatimin e duhur të Planit të Veprimit dhe raportimi mbi zbatimin e masave të PV-së. Kjo mbështet gjithashtu kapacitetet planifikuese të institucioneve të përfshira.
7. Adoptimi i qasjes sektoriale duhet të merret në konsideratë, edhe në kuadër të zbatimit të mbështetjes buxhetore. Ai duhet të shoqërohet me procesin paralel të ngritjes së kapaciteteve planifikuese, zbatuese dhe monitoruese të Strategjisë. Kjo do të ndihmojë në përthithjen dhe menaxhimin e asistencës teknike që partneri kryesor BE, do ti akordojë së shpejti institucioneve të përfshira në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet mbështetjes buxhetore.